



**PROCESI I BERLINIT PËR BALLKANIN PERËNDIMOR:
PËRFITIMET DHE SFIDAT PËR KOSOVËN**



PROCESI I BERLINIT PËR BALLKANIN PERËNDIMOR: PËRFITIMET DHE SFIDAT PËR KOSOVËN

Ky raport është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe nga Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe i menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analizat në këtë raport politik janë vetëm të Grupit për Ballkan dhe ato nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve.

Autor: Grupi për Hulumtim të Politikave në Ballkan (BPRG)

LISTA E SHKURTESAVE

BDK	Bordi Drejtues i Korporatës
BE	Bashkimi Evropian
BeH	Bosnje e Hercegovina
BEI	Banka Evropiane për Investime
BERZH	Banka Evropiane për Rikonstruim dhe Zhvillim
BQE	Banka Qendrore Evropiane
CEFTA	Marrëveshja e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë
DG NEAR	Drejtorati i Përgjithshëm për Politikat Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociim të Zgjerimit
EEAS	Shërbimi Evropian për Veprim të Jashtëm
EFTA	Asociacioni Evropian për Tregti të Lirë
ENTSO-E	Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike
IF	Institucionet Financiare
IPA	Instrumenti i Paraanëtarësimit
KE	Komisioni Evropian
KKI	Komiteti Kombëtar i Investimeve
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës
RCC	Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal
RYCO	Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor
MARRI	Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë
MiM	Memorandumi i Mirëkuptimit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
OJQ	Organizata të Shoqërisë Civile
PEIK	Projektet e Energjisë me Interes për Komunitetin
PRE	Programet e Reformës Ekonomike
SEETO	Observatori i Transportit për Evropën Juglindore
SEECF	Procesi i Bashkëpunimit për Evropën Juglindore
TEN-T	Rrjeti Trans-Evropian i Transportit
TKT	Traktati i Komunitetit të Transportit
WB6	Gjashtë Vendet e Ballkanit Perëndimor
WBIF	Forumi i Investimeve për Ballkanin Perëndimor
ZEE	Zona Ekonomike Evropiane
ZER	Zona Ekonomike Rajonale
ZRFGJ	Zyra e Rinisë Francezo-Gjermane

Tabela e Përmbajtjes

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	i
REKOMANDIMET	iii
HYRJE	1
1.BERLINI PLUS	3
NDËRMJET SAMITEVE	4
AGJENDA E KONEKTIVITETIT	5
SAMITI I VJENËS 2015.....	5
SAMITI I PARISIT 2016	7
ZYRA RAJONALE E BASHKËPUNIMIT RINOR (RYCO).....	8
SAMITI I TRIESTES 2017	8
ZONA EKONOMIKE RAJONALE	9
TRAKTATI I KOMUNITETIT TË TRANSPORTIT	11
SHOQËRIA CIVILE	11
2.ÇFARË NËNKUPTON PROCESI I BERLINIT PËR KOSOVËN?	13
TRANSPORTI	15
ENERGJIA.....	16
BASHKËPUNIMI EKONOMIK RAJONAL.....	17
MOSMARRËVESHJET BILATERALE	18
3.PARA SAMITIT TË LONDRËS: KU PO SHKON PROCESI?	18
PËRFUNDIM	20

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Procesi i Berlinit është një iniciativë e udhëhequr nga Gjermania, qëllim i së cilës është lehtësimi i bashkëpunimit rajonal në mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor (WB6) – Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës (BeH), Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë – me vizionin që t’iu ndihmohet në përmbushjen e kriterëve për të u anëtarësuar në Bashkimit Evropian (BE). I nisur në vitin 2014 nga kancelarja gjermane, Angela Merkel, komponenti i tij më i rëndësishëm i procesit të Berlinit, është e ashtuquajtura “Agjenda e Konektivitetit”, e cila fillimisht synon që gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor t’i lidhë mes vete në fushat e transportit dhe energjisë, dhe më vonë kjo lidhje të zgjerohet edhe në shkëmbimin për rininë dhe në bashkëpunimin ekonomik. Samitet e mbajtura në Gjermani, Austri, Francë dhe Itali ndihmuan në vendosjen e komunikimit ndërmjet liderëve të Ballkanit, si dhe në dizajnimin e disa projekteve infrastrukturore dhe të iniciativave rajonale. Megjithatë, pak para Samitit të ardhshëm të Procesit të Berlinit, i cili do të mbahet në Londër në vitin 2018, shumë çështje që krijojnë tensione vazhdojnë të mbesin të pazgjidhura, ndërkohë që as bashkëpunimi ndërmjet WB6 nuk ka përparuar shumë.

Projektet e miratuara për secilin shtet të WB6-së financohen pjesërisht nga mekanizmat e BE-së dhe pjesërisht nga vetë këto shtete. Agjenda e Konektivitetit kombinon politikat dhe infrastrukturën, duke ndërlidhur kështu shtetet e WB6-së ndërmjet vete dhe me BE-në: qeveritë kanë vendosur një rrjet themelor dhe gjithpërfshirës rajonal të infrastrukturës, duke e bërë kështu Ballkanin Perëndimor pjesë të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T). Gjithashtu, Procesi i Berlinit ka gjeneruar edhe iniciativa të lidhjeve rajonale, siç janë bashkëpunimi në energji, Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor (RYCO), krijimi i një Zone Ekonomike Rajonale dhe nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit.

Sido që të jetë, suksesi i iniciativës së nisur me Procesin e Berlinit varet nga përmirësimi i marrëdhënieve në mes vetë vendeve të Ballkanit Perëndimor. Në vitin 2015, qeveritë kanë aprovuar një Deklaratë për Bashkëpunim Rajonal dhe për Zgjidhjen e Çështjeve Bilaterale; megjithatë marrëdhëniet ende mbesin të tensionuara. Kontestet e pazgjidhura do të pengojnë implementimin e iniciativave rajonale, gjë që si rrjedhojë, do të reflektojë keq në vlerësimin e qytetarëve për Procesin e Berlinit, si dhe për vetë rolin e BE-së në rajon. Përmes përfshirjes së shoqërisë civile, por edhe nxitjes së bashkëpunimit rajonal, që nga Samiti i Vjenës i vitit 2015, pjesëmarrësit e Procesit të Berlinit po tentojnë që këtë iniciativë ta bëjnë sa më gjithëpërfshirëse dhe më transparente. Megjithatë, segmente të mëdha të shoqërisë civile nuk janë të përfaqësuar denjësisht, përderisa edhe vet Forumi i Shoqërisë Civile drejtohet nga vetëm disa organizata dhe donatorë.

Rruga e Kosovës drejt BE-së është më sfiduese në shumë aspekte: pesë shtete antëare të BE-së nuk e njohin pavarësinë e saj, duke e bërë kështu të pamundur që BE-ja të ofrojë një perspektivë të qartë për antarësimin e saj; kontestet e pazgjidhura me Serbinë dhe mungesa e marrëdhënieve me BeH-në, po e pengojnë integrimin rajonal të Kosovës. Përparimi në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë nuk e ka hequr bllokadën e Beogradit ndaj anëtarësimit të Kosovës në shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, për Prishtinën procesi ka sjellë përfitime të konsiderueshme; vendi është bërë pjesë e një numri të madh të iniciativave të BE-së, dhe ai gëzon një pozitë të barabartë me vendet fqinje për sa i përket projekteve dhe pjesëmarrjes në Procesin e Berlinit. Kosova ka përfituar një projekt për transportin dhe ka miratuar një numër të madh të iniciativave rajonale, si për shembull TEN-T, RYCO, ZRE dhe TKT. Përkundër përparimit të konsiderueshëm,

performanca e Kosovës në shumë sfera të tjera, përfshirë Procesin e Berlinit, po pengohet nga paqëndrueshmëria politike, insitucionet e dobëta dhe mungesa e koordinimit ndërmjet instiucioneve qeveritare.

Krahas reformave të brendshme, Kosova duhet të nxisë edhe përfshirjen e saj në iniciativa rajonale, por edhe të avokojë shumë aktivisht për përmirësimin e marrëdhënieve me fqinjët. Në samitin e ardhshëm të vitit 2018, Londra do të preferojë që ta shtyjë përpara një agjendë më të zgjeruar, duke u fokusuar në çështjet e pazgjidhura bilaterale, monitorimin e implementimit dhe në çështjet e sigurisë. Çështjet bilaterale, sundimi i ligjit dhe qeverisja e mirë do të duhej të ndërlihdeshin me projektet e Konektivitetit dhe të bashkëpunimit rajonal, duke pasur parasysh se marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore e përforcojnë suksesin e vetë agjendës dhe të projekteve. Mbretëria e Bashkuar duhet që të insistojë në veçanti në zgjidhjen e kontesteve bilaterale, por edhe në implementimin e projekteve dhe marrëveshjeve ekzistuese, në vend se të insistojë në hapjen e temave të tjera.

Sipas të gjitha gjasave, Procesi i Berlinit do të vazhdojë edhe pas Samitit të Londrës. Ai duhet të kthehet sërish në Berlin për një shqyrtim shtesë dhe karikim me fuqi dhe agjendë. Për t'i arritur objektivat e synuara, ai duhet të vazhdojë të udhëhiqet nga BE. Njëkohësisht, Procesi duhet të gjenerojë më shumë pronësi të iniciativave rajonale: shumë i rëndësishëm është bashkëpunimi bilateral dhe shpërndarja e drejtë e iniciativave rajonale. Frika se Procesi i Berlinit është vetëm një përpjekje e BE-së për të vonuar anëtarësimin e vendeve të Ballkanit në BE ka filluar të zbehet. Katër vite pas debutimit të tij, Bashkimi Evropian ka iniciuar planet e tij për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE. Katër vite janë një periudhë e shkurtër për të vlerësuar rezultatet e Agjendës së Berlinit; përkundër shumë hipotezave pozitive dhe negative, sukcesi i plotë i këtij procesi mbetet të shihet më vonë.

Për të siguruar suksesin, Agjenda e Berlinit duhet të përfshihet në Strategjinë e BE-së për Zgjerimin e Ballkanit Perëndimor, e cila është paraparë të publikohet gjatë shkurtit të vitit 2018. Agjenda e Berlinit duhet të luajë rol edhe në Samitin BE-Ballkani Perëndimor, i cili do të mbahet në Sofje. Si një instrument shtesë krahas negociatave për anëtarësim, procesi i Berlinit do të duhej që si prioritet të ketë ofrimin e ndihmës ndaj vendeve të Ballkanit për zgjidhjen e të gjitha çështjeve bilaterale. Duke e fuqizuar "integrimin e Gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor", Agjenda e Berlinit mund të fusë brenda strategjisë së BE-së për Zgjerim, edhe peshën politike të shteteve kryesore anëtare të BE-së. Po ashtu, procesi i Berlinit mund të kontribuojë edhe me projekte rajonale e zhvillimore.

REKOMANDIMET

PËR BE-në, PROCESIN E BERLINIT, ANËTARËT E BE-së (DHE BALLKANIN PERËNDIMOR)

- Brukseli dhe anëtarët e BE-së pjesë e Procesit të Berlinit duhet të insistojnë në zbatimin e plotë të projekteve dhe përmbushjen e zotimeve.
- Të krijohen dhe të sigurohen raportime të rregullta mbi ecurinë e zbatimit. Mekanizmat monitorues duhet të jenë funksionalë dhe të përfshijnë sektorët joqeveritarë, respektivisht shoqërinë civile.
- Të prioritetizohet zgjidhja e çështjeve bilaterale: zbatimi i projekteve varet nga raportet e shëndosha mes shteteve të rajonit. Të emërohet një koordinator në nivel të BE-së, ose brenda vetë instrumenteve të Agjendës së Procesit të Berlinit, i cili do të monitorojë dhe raportojë për përparimin e arritur në marrëdhëniet bilaterale.
- Të zgjerohet Agjenda e Berlinit edhe me tema të tjera sektoriale dhe fusha prioritare të BE-së: Sundimi i ligjit, qeverisja e mirë, arsimi dhe trajnimet profesionale, pajtimi dhe bashkëpunimi rajonal.
- Të shtohen fondet për projekte infrastrukturore, energjetike, ambientale, si dhe për furnizim me ujë të pijshëm dhe menaxhim të mbeturinave.
- Të rritet mbështetja financiare për Forumin e Shoqërisë Civile dhe ftohet të marrë pjesë në samite. FSHC-ja duhet të ristrukturohet, me qëllim që të sigurojë përfaqësim të barabartë dhe kontributin e duhur nga secili vend i gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor; duhen krijuar zyre të veçanta në secilin shtet.

PËR KOSOVËN

- Qeveria duhet të punojë drejt dhe të avokojë për zgjidhjen e kontesteve bilaterale, të përshpejtojë dialogun me BE-në dhe me partnerët e tjerë kyç, për të siguruar kështu pajtimin dhe zbatimin nga ana e Serbisë, të gjithë marrëveshjeve të arritura mes dy vendeve.
- Kompetencat për të koordinuar dhe përgatitur agjendat, projektet dhe iniciativat me sektorët e tjerë qeveritarë duhet t'i delegohen një zyrtari të lartë të kabinetit të kryeministrit; ky zyrtar duhet të punojë ngushtë me Ministrinë e Integritimit Evropian, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Infrastrukturës dhe me ministritë e tjera përkatëse.
- Agjenda e Procesit të Berlinit duhet të integrohet në kuadër të agjendës së Qeverisë së Kosovës. Qeveria duhet të jetë transparente për të gjitha përgatitjet, projektet dhe dokumentet zyrtare që kanë të bëjnë me Agjendën e Berlinit, si dhe të njoftojë publikun për të gjitha përparimet e arritura; shoqëria civile do të mund të ishte një partner i mirë për këtë punë.
- Ministritë duhet të emërojnë zyrtarë të aftë dhe kompetentë, për të siguruar kështu një përgatitje dhe planifikim të avancuar të projekteve.
- Me qëllim të zhvillimit të projekteve dhe ideve të reja, Kosova duhet ta përfshijë në mënyrë më proaktive sektorin e organizatave joqeveritare. Qeveria duhet të përfshijë dhe mobilizojë rininë, komunitetin e IT-së, bizneset fillestare dhe institucionet që merren me trajnime profesionale, për të siguruar kështu financimin dhe mbështetjen e institucioneve financiare të Procesit të Berlinit, por edhe të agjendave të ardhshme të Berlinit Plus.

- Kosova duhet të rrisë bashkëpunimin me fqinjët e tjerë, për të përgatitur projekte më të realizueshme dhe për të siguruar mbështetje për to.
- Qeveria duhet ta prioritzojë zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe të reformave të tjera që ndërlidhen me proceset integruese në BE. Kjo do të përmirësojë imazhin dhe performancën e Kosovës karshi BE-së dhe shteteve anëtare të Procesit të Berlinit.
- Shoqëria civile e Kosovës duhet të mobilizohet për të ndihmuar qeverinë për projekte dhe bashkëpunimin rajonal.
- Po ashtu, shoqëria civile duhet të jetë më proaktive në samitet që do të ndodhin së shpejti, por edhe në takimet rajonale dhe në forumet e shoqërisë civile, duke avokuar për temat që janë në interes të saj. Shoqëria civile duhet të marrë përsipër një rol më aktiv, duke krijuar grupin e përfaqësuesve të saj. Ajo duhet të shqyrtojë zhvillimin e mekanizmave për mbledhje fondesh. Kjo gjë duhet të merret në konsideratë para se të mbahet Samiti i Londrës. Gjithashtu, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me marrëdhëniet bilaterale në rajon dhe ato për integrimin e Kosovës në BE, duhet shtuar vëmendja dhe debati për Sundimin e Ligjit dhe Qeverisjen e Mirë.

HYRJE

Procesi i Berlinit, i nisur në vitin 2014, synon të rrisë bashkëpunimin mes shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe zhvillimin e tyre. Kjo iniciativë e udhëhequr nga Gjermania, nëpërmjet kancelares Angela Merkel dhe ish-ministrit të Jashtëm Frank-Walter Steinmeier, synon lehtësimin e zhvillimit në sferat e “pajtitimit, stabilizimit, sektorit energjetik, sundimit të ligjit, ekonomisë së tregut dhe të shtet-ndërtimit” mes gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor (WB6).¹ Agjenda e Konektivitetit, e cila përfshin zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe energjisë, përmirësimin e lidhjeve rajonale dhe thjeshtimin e lëvizjes së mallrave dhe njerëzve, përbën bazamentin e Procesit të Berlinit.² Bashkimi Evropian (BE) e prezantoi Procesin e Berlinit si një rrugë për lehtësimin e integritet të WB6-së në BE. Perceptimi fillestar në Ballkanin Perëndimor ishte se Procesi i Berlinit ishte një zëvendësim për integritet në BE.³ Sukses i Agjendës së Berlinit në rajon, e veçanërisht në Kosovë, është tejet i diskutueshëm. Në mesin e pengesave të shumta të Procesit të Berlinit është edhe fshehja e problemeve bilaterale dhe mungesa e transparencës së qeverive gjatë gjithë procesit.

Samiti i Ballkanit Perëndimor, i vitit 2003 në Selanik, premtoi një thellim të marrëdhënieve mes BE-së dhe Ballkanit Perëndimor.⁴ Megjithatë, perspektiva e anëtarësimit në BE nuk pati progres; në realitet ajo stagnoi. Dështimi i Samitit të Selanikut e nxiti Gjermaninë që të sjellë një incitivë të re në rajon.⁵ U gjet momenti i duhur, pikërisht atëherë kur politika e zgjerimit po sfidohej në mënyrë kritike, pasi BE-ja po ndalonte hyrjen për shtetet e reja anëtare. Kriza e brendshme e paprecedent në BE, rritja e lëvizjeve populiste, pengesat e vendosura ndaj emigracionit, kriza e vazhdueshme ekonomike dhe rritja e terrorizmit, absorbuan të gjitha kapacitetet e saj politike.⁶ Duke pasur raporte të fuqishme bilaterale me secilin shtet të WB6-së veç e veç, Gjermania mori përsipër drejtimin e iniciativës së Procesit të Berlinit. Sipas fjalëve të një diplomati gjerman: “Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor është oborri ynë, andaj ne e ndiejmë nevojën për të ndihmuar”.⁷ “Kjo është iniciativa më e sukseshme nga të gjitha iniciativat e tjera rajonale, kryesisht për shkak se ajo përfaqëson një agjendë të udhëhequr nga Berlioni. Liderët e WB6-së bashkëpunojnë vetëm atëherë kur në tavolinë flasin gjermanët”.⁸

Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia – Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor dhe gjashtë shtetet anëtare të BE-së: Gjermania - Austria, Franca, Kroacia, Italia dhe Sllovenia - janë shtetet kryesore pjesëmarrëse në Procesin e Berlinit.⁹ Kryeministrat takohen një herë në vit dhe ndërmjet samiteve; këshilltarët e kryeministrave takohen në çdo tre muaj; ministrat e energjisë, transportit, tregtisë dhe të punëve të jashtme takohen dy herë në vit ose ndërmjet samiteve; takimet teknike mbahen gjatë gjithë vitit dhe ato zakonisht kryesohen nga mekanizmat e ndryshëm, përfshirë këtu Asociacionin e Evropës Qendrore për Tregti të Lirë (CEFTA) dhe Forumin e Ballkanit Perëndimor për Investim (WBIF).¹⁰

¹ Komunikata për shtyp e ministrit të jashtëm Steinmeier lidhur me takimin me ministrat e jashtëm të shteteve të Ballkanit Perëndimor, korrik 2016, e qasshme në: <https://goo.gl/U7paZi>

² Grupi për Ballkan, intervistë me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

³ B92, “Procesi i Berlinit nuk duhet të jetë një zëvendësim për integritet në BE”, janar 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/dFNXwD>

⁴ Komunikata për shtyp e Këshillit të Evropës, “Samiti i Selanikut: Një moment historik në marrëdhëniet e Bashkimit Evropian me Ballkanin Perëndimor”, qershor 2003, e qasshme në: <https://goo.gl/hBBkvy>

⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, korrik 2017

⁶ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ShtetiWeb, “Monitorimi i Procesit të Berlinit, nga Berlioni deri në Trieste”, janar 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/dVGkSm>

⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, korrik 2017

⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

⁹ Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, “Procesi i Berlinit: Rruga për Evropë apo për askund?”, korrik 2016, i qasshëm në: <https://goo.gl/sJsvvg>

¹⁰ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

Deklarata përfundimtare e Samitit të Berlinit e përcakton iniciativën e Procesit të Berlinit si një kornizë me afat katërvjeçar.¹¹ Po vijojnë diskutimet rreth iniciativës që do të vazhdojnë edhe pas vitit 2018.¹²

Në vitin 2014, kandidati për president të Komisionit Evropian, Jean-Claude Juncker, deklaroi se gjatë pesë viteve të ardhshme nuk do të ketë zgjerim të ri.¹³ Deklarata e tij nxiti një jehonë pesimizmi ndër shtetet e Ballkanit Perëndimor, dhe prodhoi paqëndrueshmëri, tensione dhe një ndjenjë të humbjes së besimit ndaj BE-së. Rajoni po largohej gjithnjë e më shumë nga vlerat e BE-së. Iniciativa e Berlinit synonte kthimin e trendeve, përmes projektimit të një perspektive më të madhe të BE-së për rajonin. Për WB6-n, procesi ndihmoi në mbajtjen gjallë të shpresës, në një situatë kur realisht asnjëri nga WB6 nuk ishte gati që t'i bashkohej BE-së. Duke e marrë parasysh këtë, shtetet e tjera anëtare të BE-së ngurrnin të mirëprisnin shtete të reja. Prosesi i Berlinit ua la barrën vetë shteteve të WB6 që të punonin së bashku për të përmbushur kriteret e Kopenhagës për hyrje në BE.¹⁴

Në praktikë, Agjenda e Procesit të Berlinit paraqet një ambrellë gjithëpërfshirëse që bashkon mekanizmat të shumtë për fuqizimin e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik të WB6-s. Iniciativat tematike rajonale të nisura nga BE-ja, sikurse janë Këshilli për Bashkëpunim Rajonal (KBR), Observatori i Transportit të Evropës Juglindore (SEETO), Prosesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore (SEECF), Iniciativa Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI), Forumi Ministror BE-BP, dhe Prosesi i Brdo-Brijuni i udhëhequr nga Sllovenia e Kroacia, i cili ose mbivendos, ose plotëson disa prej temave që ceken në Agjendën e Berlinit. Komitetet Kombëtare të Investimeve (KKI) janë përgjegjëse për definimin dhe menaxhimin e Listës së Projekteve Prioritare dhe për programimin e burimeve të financimit nga donatorët vendorë ose ndërkombëtarë.¹⁵ Komisioni Evropian, nëpërmjet Kornizës së Ballkanit Perëndimor për Investime (KBPI), bashkëfinancon projekte të energjisë dhe transportit nga lista e Projekteve me Interes të Komunitetit të Energjisë (PIKE) dhe të Rrjetit Trans-Evropian të Transportit (TEN-T).¹⁶ Një rol të rëndësishëm në financim luajnë edhe kreditë nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç janë Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane për Investime (BEI), Banka Botërore, dhe WBIF.

¹¹ Deklarata Përfundimtare e kryesuesit të Konferencës për Ballkanin Perëndimor, gusht 2014, gjendet në: <https://goo.gl/p7dBoz>

¹² Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë perëndimor, Prishtinë, korrik 2017

¹³ Jean Claude Juncker gjatë hapjes së sesionit plenar të Parlamentit Evropian, "Një fillim i ri për Evropën", korrik 2014, i qasshëm në: <https://goo.gl/Ci5LZH>

¹⁴ Intervistë e Grupit për Ballkan me një analist ballkanik, nëntor 2017

¹⁵ Agjenda e Konektivitetit, Bashkëfinancimi i Projekteve Investive në Ballkanin Perëndimor 2015, Agjenda e Konektivitetit – Partneriteti i Përbashkët; Përmirësimi i lidhjeve brenda Ballkanit Perëndimor, por edhe i atyre mes Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian, si faktorë vendimtarë për rritjen dhe punësimin, që do të sillnin përfitime të qarta për ekonomitë dhe banorët e rajonit, i qasshëm në: <https://goo.gl/nUP71e>

¹⁶ Ibid

1. BERLINI PLUS

Programet dhe iniciativat e Procesit të Berlinit duket se janë të vështira dhe po zbatohen ngadalë. Si gjithmonë, qeveritë e rajonit janë kontradiktore dhe kanë performancë të dobët. Mungesa e kompetencës së qeverive ka penguar edhe të gjitha iniciativat e mëhershme, andaj ka gjasa që kjo të rezultojë me rënie të përkushtimit ndaj Agjendës së Berlinit dhe proceseve të tjera integruese. Asnjë proces i BE-së nuk siguron rezultate aq të shpejta sa për të kënaqur liderët e Ballkanit Perëndimor; qeveritë mbesin të pashpresa dhe të padurueshme për integrimin në BE. BE-ja nuk arriti t'u japë shteteve të Ballkanit Perëndimor premtime më të fuqishme për anëtarësim.¹⁷ Tek qeveritë rajonale ekziston një nivel i lartë i mosbesimit ndaj Komisionit Evropian.¹⁸ Projektet atraktive rajonale dhe qëllimet e mira të Agjendës së Berlinit nuk arritën që t'i bëjnë qeveritë ngurruese të përshpejtojnë reformat dhe të shtojnë bashkëpunimin dhe zhvillimin.¹⁹

Me synim të zgjerimit të Agjendës së Berlinit, ministri i jashtëm gjerman, Sigmar Gabriel, më 31 maj 2017 deklaroi se Procesi i Berlinit duhet të mos ndalet në vitin 2018, por të "fuqizohet".²⁰ Në Ballkanin Perëndimor kjo shprehje shumë shpejt u quajt "Agjenda Berlini Plus".²¹ Gabriel vuri theksin mbi çështjet e përçarjeve politike, korrupsionit, stagnimit ekonomik, paqëndrueshmërisë politike dhe të papunësisë së të rinjve në shtetet e BP. Ai deklaroi se rajoni ka nevojë për një agjendë të re për adresimin e çështjeve në nivele të ndryshme.²² WB6-a dhe BE-ja duhet të jenë më ambiciozë dhe të përfshihen në më shumë programe të BE-së.²³ Po ashtu, Gabriel theksoi se qytetarët e WB6-s nuk kanë informacion lidhur me mbështetjen e BE-së. Ai pohoi se, nëse qytetarët e WB6-s nuk kanë aq shumë njohuri për mbështetjen e BE-së, atëherë nuk është çudi që interesimi i tyre për procesin e anëtarësimit është i kufizuar. BE-ja dhe WB6-a duhet të bëjnë pëmirësime në këtë aspekt.²⁴ Agjenda Berlini Plus do të ndajë fonde për biznese fillestare, trajnime profesionale dhe për zhvillimin e infrastrukturës së TI-së. Shtetet anëtare të BE-së, Asociacioni Evropian i Tregtisë së Lirë (EFTA) dhe Zona Ekonomike Evropiane (ZEE) do të kontribuojnë në këto fonde. Gjermania parashikon iniciimin e instrumenteve për nevojat e rajonit. Fondet e reja, sapo të jenë në dispozicion, do të ndihmojnë në përshpejtimin e projekteve dhe do të forcojnë lidhjen mes shteteve të Ballkanit që janë më pak të lidhura.²⁵

¹⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë perëndimor, Prishtinë, gusht 2017

¹⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar, Prishtinë, korrik 2017

¹⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë perëndimor, Prishtinë, korrik 2019

²⁰ Fjalimi i ministrit të Jashtëm Sigmar Gabriel, në Konferencën e Tetë të Ministrave të Jashtëm të Evropës Juglindore, në Aspen, "Ne na duhet një 'rikarikim' i Procesit të Berlinit", maj 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/BM2ZhK>

²¹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë perëndimor, Prishtinë, korrik 2017

²² Fjalimi i ministrit të Jashtëm Sigmar Gabriel, në Konferencën e Tetë të Ministrave të Jashtëm të Evropës Juglindore, në Aspen, "Ne na duhet një 'rikarikim' i Procesit të Berlinit", maj 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/BM2ZhK>

²³ Ibid

²⁴ Adresimi i çështjes së transparencës në WB6 është me rëndësi kryesore. Zbrastësira mes qeverisë dhe qytetarëve karshi integritimit në BE dhe Procesit të Berlinit është e gjerë.

²⁵ Ibid.

NDËRMJET SAMITEVE

Kryeministrat takohen në samite vjetore dhe ndërmjet samiteve. Këshilltarët e kryeministrave takohen një herë në tre muaj, në DG NEAR, në Bruksel, me qëllim të koordinimit të agjendave.²⁶ Ministrat e energjisë, transportit, tregtisë dhe punëve të jashtme takohen një herë ose dy herë ndërmjet samiteve. Disa nga këto takime tashmë janë bërë shumë joformale dhe gati të pavlera.²⁷ Këshilltarët e liderëve qeveritarë nuk kanë kompetenca të plota për të negociuar agjendat, përderisa kryeministrat delegojnë zyrtarë të nivelit të ulët për të marrë pjesë në takime.²⁸ Shpeshherë, ministrat nuk paraqiten me kohë, ose diskutimet e tyre kalojnë në konteste bilaterale.²⁹ Përgatitjet zakonisht bëhen në minutat e fundit para samiteve. Gjithashtu, shumë pak dihet apo bëhet e ditur për atë që ndodh ndërmjet samiteve, si brenda qeverive, ashtu edhe për publikun e gjerë.

Pas Konferencës së Berlinit të vitit 2014, kryeministrat dhe ministrat u takuan shtatë herë ndërmjet samitit të Vjenës dhe atij të Parisit, për të diskutuar tema të tjera, përfshirë edhe menaxhimin e krizës së emigrantëve.³⁰ Përfshirja e BERZH-it dhe integrimi i procesit të Brdo-Brijunit në Procesin e Berlinit, ishin hapa të rëndësishëm. Përpara Samitit të Triestes, përfaqësuesit e shteteve u takuan në Sarajevë dhe në Berlin. Dy takime joformale të kryeministrave u mbajtën në Sarajevë dhe në Durrës. Në Sarajevë pati rritje të tensioneve ndërmjet kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, dhe atij të Serbisë, Aleksandar Vučić, duke reflektuar kështu tensionet politike ndërmjet këtyre dy shteteve.³¹ Aty pati diskutime të vështira për bashkëpunimin ekonomik rajonal. Kosova dhe Mali i Zi iu kundërvunë propozimit të Vučić për krijimin e një unioni doganor të WB6-së.³² Megjithatë, takimi i kryeministrave në Durrës në vitin 2017, përfundoi qetë dhe liderët konfirmuan përkushtimin e tyre për Zonën Ekonomike Rajonale (ZER), të miratuar në Samitin e Triestes.³³ Për shkak të çështjeve të pazgjidhura të shteteve mes njëri-tjetrit, gjatë këtyre takimeve u ndje tension dhe zemërim.

²⁶ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ShtetiWeb, "Monitorimi i Procesit të Berlinit: Nga Parisi në Trieste", janar 2017, i qasshëm në: <http://goo.gl/hBgdy3>

²⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar, Prishtinë, korrik 2017

²⁸ Ibid.

²⁹ Ministrat e infrastrukturës të Kosovës dhe Serbisë takohen rrallëherë ndërmjet samiteve. Intervistë e Grupit për Ballkan, me qeveritarë dhe zyrtarë të BE-së, korrik 2017. Shumë shpesh ministrat serbë nuk marrin pjesë në takimet ministrore nëse prezentë janë homologët e tyre nga Kosova.

³⁰ Takimet përcjellëse 2015-2016: "Ekonomia – Bazë lidhëse për Ballkanin Perëndimor", në Budva, 24 shtator 2014; "Qeverisja ekonomike dhe Lidhja", në Beograd, më 23 tetor 2014; Ministror: "Lidhja e Përmirësuar dhe Rrjeti i Fuqishëm Themelor", në Prishtinë, 25 mars 2015; Samiti i WB6-së: "Ndërtimi i Rrjeteve Lidh Njerëzit", në Bruksel, 21 prill 2015; Ministror: "Agjenda Pozitive për Rininë e Ballkanit Perëndimor", në Brdo, 23 prill 2015; Takimi në Forumin e TEN-T në Riga, 22 qershor 2015; Ministror: "Lidhja e Sistemeve Lidh Tregjet" në Vjenë, 2 qershor 2015; Takim Përcjellës: Koneferencë e Nivelit të Lartë për Mesdheun Lindor – Rruga e Ballkanit Perëndimor, Punët e Brendshme dhe Punët e Jashtme", 28 tetor 2015; Takim i liderëve për Rugën e Ballkanit Perëndimor të Imigrimit, Punët e Brendshme dhe Punët e Jashtme, 25 tetor 2015; Samiti i Ballkanit Perëndimor, Ekonomia dhe Tregtia, 22 shkurt 2016; Takim i WB6-së në Bruksel, Transporti dhe Energjia, 1 mars 2016; Takim Ministror i WB6-së në Durrës, Punët e Jashtme, 30-31 mars 2016; Konferencë Biznesore: Lidhja për Tregti dhe Investime, Ekonomia dhe Tregtia, 18-19 maj 2016; Konferencë Ministrore në Paris, Punët e Jashtme, 24 maj 2016.

³¹ B92, "Darkë e Tensionuar në Sarajevë, sepse Vučić i bërtet Mustafës", mars 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/6tr5zo>

³² Disa liderë ishin të zemëruar në komisarin e BE-së, Johannes Hahn, i cili në fund përkrahu propozimin e Serbisë. Hahn prezantoi Zonën Ekonomike Rajonale, të bazuar në idenë e Vučić. Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar, Prishtinë, korrik 2017

³³ DG NEAR, "Johanes Hahn merr pjesë në takimin joformal të kryeministrave të Ballkanit Perëndimor, në Durrës, Shqipëri", gusht 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/fQHKHz>

AGJENDA E KONEKTIVITETIT

Agjenda e Konektivitetit synon përmirësimin e koneksionit në mes të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe shteteve të BE-së. Përmirësimi i lidhjeve në infrastrukturë sjell përfitime të dukshme për ekonominë dhe banorët e rajonit.³⁴ Koneksioni i sistemeve të transportit dhe energjisë është në bërthamën e Agjendës së Berlinit.³⁵ Procesi i Berlinit bën dallimin mes masave të forta, të cilat përfshijnë projektet infrastrukturore rajonale dhe kombëtare, dhe masave të buta, të cilat përfshijnë procedurat e kalimit të kufijve, reformat hekurudhore, sistemet e informimit, sigurinë rrugore, skemat e mirëmbajtjes, pengimin e qasjes për palët e treta, dhe masat të tjera strategjike.³⁶ Synimi i këtyre strategjive është që të eliminohen pengesat dhe të lehtësohet integrimi rajonal.³⁷ Bashkë-investimi në infrastrukturë, apo masat e forta, varet shumë nga zbatimi i masave të buta, përfshirë këtu edhe përshtatjen e legjislacionit në fuqi.³⁸ Nuk mund të ketë një zbatim të plotë të masave të forta nëse nuk janë zbatuar masat e buta.³⁹ Për periudhën 2014 - 2020, BE-ja ka ndarë afër 1 miliard euro për investime në projekte dhe për asistencë teknike. Këto fonde i shtohen fondeve të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA) për shtetet e Ballkanit Perëndimor.⁴⁰ Qeveritë janë shumë të pakënaqura me këtë ndarje fondesh, duke theksuar se ajo ofron shumë pak krahasuar me atë që i duhet rajonit. Iniciativa Connecta do të mbështesë krijimin dhe përf forcimin e një kornize rregulluese dhe institucionale, e cila do të mundësojë që Ballkani Perëndimor të marrë përfitimet maksimale të investimeve infrastrukturore.⁴¹ Megjithatë, nuk është arritur ndonjë progres i madh. Qeveritë kanë dështuar të jetësojnë agjendat për të cilat kanë dhënë zotimin; ato janë shumë joefektive dhe të prirura për konflikte të brendshme. Marrëdhëniet bilaterale mbesin një pengesë tjetër e rëndësishme. Si rrjedhojë, BE-ja ka premtuar se do t'i ndihmojë shtetet në trajtimin dhe zbatimin e këtyre problemeve bazike strategjike.⁴²

SAMITI I VJENËS 2015

Samiti i parë pas deklaratës së Berlinit të vitit 2014, u mbajt në Vjenë, më 27 gusht 2015. Qëllimet kryesore ishin nxitja e bashkëpunimit rajonal dhe zgjidhja e kontesteve bilaterale.⁴³ Samiti çoi përpara agjendën e pajtimit dhe të konektivitetit. Mes qëllimeve të cekura nga shtetet pjesëmarrëse në Samitin e Vjenës për Ballkanin Perëndimor, ishin:

- Qeverisja e mirë dhe sundimi i ligjit
- Luftimi i ekstremizmit dhe radikalizimit
- Migrimi

³⁴ Agjenda e Konektivitetit, Projektet e bashkëfinancuara në Ballkanin Perëndimor nga ana e Komisionit Evropian.

³⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

³⁶ Agjenda e Konektivitetit, Projektet e bashkëfinancuara në Ballkanin Perëndimor 2015; Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor e ka bërë agjendën e konektivitetit një ndër prioritetet e saj kryesore, me theks të veçantë në implementimin e standardeve teknike, por edhe të masave të buta, i qasshëm në: <https://goo.gl/nUP71e>

³⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtarë të BE-së, Prishtinë, 2017

³⁸ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/Shteti., Monitorimi i Procesit të Berlinit: Nga Parisi deri në Trieste, janar 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/hBgdY3>

³⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

⁴⁰ Instituti për Demokraci "Societas Civilis", Qendra e Politikave të BE-së për Shqipëri, e Fondacionit për Shoqëri të Hapur, "Procesi i Berlinit: Çfarë u tregua e suksesshme, e çfarë jo? dhe përse?", 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/aaJkkU>

⁴¹ Ibid.

⁴² Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtarë të BE-së, Prishtinë, gusht 2017. Brukselit i duhet të ndërhyjë në secilin detal të çështjeve mes Serbisë dhe Kosovës, për zbatimin e marrëveshjeve, dhe të reagojë dhe ndërmjetësojë ndaj cilitdo efekt të dëmshëm. BE-ja ndërhyrë brenda Bosnje e Hercegovinës, por edhe në shumicën e çështjeve më esenciale brenda shteteve apo edhe ndërmjet fqinjëve. Nëse shtetet e Ballkanit Perëndimor do të kishin marrëdhënie të mira bilaterale, ato do të ishin në gjendje që çështjet t'i zgjidhnin vetë njëri me tjetrin.

⁴³ Është nënvizuar në Deklaratën Përfundimtare të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, të mbajtur në gusht 2015.

- Prosperiteti ekonomik dhe konektiviteti
- Integrimi i tregut, lehtësimit i tregtisë, mobilitetit dhe Iniciativa e Rritjes së Përbashkët
- Rinia, arsimit, shkencës dhe hulumtimet
- Shoqëria civile⁴⁴

Liderët e Ballkanit Perëndimor miratuan Deklaratën për Bashkëpunim Rajonal dhe për Zgjidhjen e Kontesteve Bilaterale, në të cilën shtetet zotohen se do të nxisin marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe do të zgjidhin çështjet bilaterale.⁴⁵ Qëllimi i kësaj deklarate ishte inkurajimi i shteteve të Ballkanit Perëndimor për t'i dhënë përparësi zgjidhjes së kontesteve bilaterale në fazat e hershme të procesit të tyre të anëtarësimit. Zgjidhja e çështjeve bilaterale është qenësore për çfarëdolloj iniciative rajonale të bashkëpunimit, përfshirë këtu edhe Procesin e Berlinit. Shoqëria civile kontribuoi në përpilimin e deklaratës dhe avokoi për ndërmarrjen e hapave të tjerë konkretë: ajo rekomandoi caktimin e një koordinatori në Shërbimin Evropian të Veprimit të Jashtëm (EEAS) për të monitoruar progresin e arritur.⁴⁶ Pati arritje shumë të vogla; në vitet e Procesit të Berlinit, mospajtimet politike dhe tensionet në rritje ishin edhe më të shpeshta. Samiti nuk arriti të prodhojë asnjë jlok agjende specifike për zgjidhjen e çështjeve të hapura mes shteteve. Nuk u dizajnuan asnjë instrument monitorimi, ndërkohë që BE-ja vazhdoi të tregojë hezituesë që të ushtronte presion ndaj shteteve që të përmbushnin zotimet e tyre. Përpjekjet hasën në veshin e shurdhër të qeverive evropiane dhe atyre të Ballkanit Perëndimor. Është qëllim i tyre që të japin deklaratat dhe jo t'i vënë ato në zbatim nga ana e shteteve veç e veç.

Përkundër të arriturave të Procesit të Berlinit, mungesa e progresit në çështjet e pazgjidhura bilaterale pengon progresin në komponentat tjera të Agjendës së Berlinit.

Në Samitin e Vjenës u aprovuan gjashtë projekte për infrastrukturën e transportit dhe katër në fushën e energjisë.⁴⁷ Komisioni Evropian ndau 822.2 milionë euro në formë investimesh dhe grantesh.⁴⁸ Vjena pranoi projektin hekurudhor të Kosovës, Korridori i Orient/Lindje-Mesdhe (R10), i cili lidh Kosovën me Maqedoninë dhe Serbinë. BE-ja premtoi rreth 46 milionë euro investime dhe grante për fazën e parë të projektit⁴⁹. R10 është nënvizuar si Korridori Kryesor i Rrjetit të TEN-T.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor janë zotuar se do t'i zbatojnë disa masa ligjore dhe rregullative për të ndihmuar krijimin e tregut të energjisë elektrike. Këto zotime përfshinin zhvillimin e tregtimit të spoteve (shkëmbimi monetar), bashkimin e tregut rajonal, balancimin rajonal dhe shpërndarjen e kapaciteteve.⁵⁰ Shtetet pjesëmarrëse e kuptuan nevojën e reformave

⁴⁴ Deklarata përfundimtare e kryesuesit të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, e qasshme në: <https://goo.gl/dsvkuE>

⁴⁵ Ibid.

⁴⁶ Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, korrik 2017

⁴⁷ Deklarata përfundimtare e Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, gusht 2015, e qasshme në: <https://goo.gl/dsvkuE>

⁴⁸ Projektet e energjisë: Interkonjeksioni (I) Shqipëri – Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, rrjeti i seksionit në Shqipëri; Interkoneksioni (II) Shqipëri-Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Rrjeti i seksionit në Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë; Korridori transballkanik i energjisë elektrike (I): Rrjeti i seksionit në Mal të Zi; Korridori transballkanik i energjisë elektrike (II): Rrjeti i seksionit në Serbi; Projektet e transportit: Korridori i Mesdheut (C Vc): Interkonjeksioni rrugor Bosnje e Hercegovinë – Kroaci; Korridori i Mesdheut (R2a): Interkonjeksioni rrugor Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci; Orient/Lindje-Korridori i Mesdheut (R10): Interkonjeksioni hekurudhor Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosovë – Serbi; Orient/Lindje-Korridori i Mesdheut (R4): Interkonjeksioni hekurudhor Mali i Zi – Serbi; për më tepër: <https://goo.gl/z155wN>

⁴⁹ Korridori lidhë Kraleven (Serbi), Prishtinën (Kosovë), Gorce Petrov (Maqedoni). Projekti është i ndarë në tri faza: Fushë Kosovë- Kufiri i Maqedonisë, Fushë Kosovë – Mitrovicë, Mitrovicë - Kufiri i Serbisë. Samiti i Vjenës ka premtuar fondet për fazën e parë.

⁵⁰ Agjenda e Konektivitetit – bashkëfinancimi i Projekteve Investive në Ballkanin Perëndimor 2016; Meqë rajoni i WB6-së është i lidhur ngushtë fizikisht me shtetet fqinje që janë anëtare të BE-së, është e një rëndësie jetike që të zhvillohet një rajon i integruar tregtar i EIL-së, pjesë e të cilit do të jenë WB6-a dhe shtetet anëtare të BE-së, me qëllim të tejkalimit të kufizimit të tregjeve të vogla dhe të izoluara kombëtare, për më tepër: <https://goo.gl/nUP71e>

strukturore me qëllim të rritjes së strukturës industriale, kapitalit njerëzor e fizik dhe të integritetit tregtar, për të nxitur kështu konkurrueshmërinë në rajon.⁵¹ Shtetet pjesëmarrëse po ashtu theksuan rëndësinë e masave ekonomike për mirëqenien, megjithëse nuk i diskutuan reformat apo programet specifike. Kryeministrat e Shqipërisë dhe Serbisë, Edi Rama dhe Aleksandar Vučić, iniciuan themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunimin Rinor (RYCO) për Ballkanin Perëndimor, ndërkohë që Forumi i Shoqërisë Civile (FSHC) për herë të parë mori pjesë në Samitin e Vjenës. Samiti i Vjenës konsiderohet më i suksesshmi dhe më frytdhënës prej të gjithë samiteve të Procesit të Berlinit deri më tani.⁵²

SAMITI I PARISIT 2016

Në korrik të vitit 2016, Parisi ishte nikoqir i samitit të tretë, i cili u fokusua në katër shtylla të rëndësishme: bashkëpunimin rajonal, konektivitetin dhe tregtinë, rininë dhe në sfidat aktuale, të cilat përfshinin emigracionin, terrorizmin dhe radikalizimin.⁵³

Takimi në Paris i kushtoi një vëmendje të veçantë rinisë. Krerët e qeverive u pajtuan të themelonin një Zyrë Rajonale të Bashkëpunimit Rinor (RYCO), si dhe se duhet bërë më tepër për të ulur shkallën e lartë të papunësisë së të rinjve në rajon. WB6-a rikonfirmoi se do të punojë drejt Integritetit Evropian dhe Bashkëpunimit Rajonal. Që të dy, BE dhe Ballkani Perëndimor, identifikuan fushat ku bashkëpunimi ka nevojë të fuqizohet edhe më tepër; ripranimi i personave të dëbuar, shkëmbimi i informatave, koordinimi, operacionet e përbashkëta për luftimin e krimit, dhe bashkëpunimi ndërmjet forcave kufitare të policisë. Samiti bëri thirrje për përparim të mëtejshëm dhe për zbatimin sa më efektiv të projekteve të nisura në Vjenë në vitin 2015. Po ashtu, bëri thirrje edhe për çuarjen përpara të zbatimit të masave të buta që ndërlidhen me rrjetin e integruar të energjisë dhe transportit.⁵⁴

Qeveritë e WB6-s përkrahën Programin Rajonal për Energji Eficiente dhe Fondin Green for Growth për Skemat e Energjisë së Ripërtëritshme për Ballkanin Perëndimor. Gjithashtu, u pajtuan edhe për caktimin e udhërrëfyesit për Tregun Rajonal të Energjisë Elektrike.⁵⁵

Në Samitin e Parisit u miratuan tre projekte të reja hekurudhore në Serbi, Shqipëri dhe Kosovë, në vlerë prej 595.4 milionë euro.⁵⁶ BE-ja ndau rreth 100 milionë euro; pjesa tjetër do të mbulohet nga ana e institucioneve financiare dhe nga buxhetet vendore të shteteve përfituese. Për projektin hekurudhor R10, BERZH dhe Banka Evropiane e Investimit (BEI) kanë ndarë për Kosovën 42.3 milionë euro dhe një grant prej 18.2 milionë eurove.⁵⁷

Franca ngurronte që të merrej me shtyrjen përpara të agjendës për shkak të çështjeve bilaterale të e pazgjidhura, siç ishte dakorduar në Vjenë.⁵⁸ Pas një dreke shpresdhënëse,

⁵¹ Deklarata përfundimtare e kryesuesit të Samitit të Vjenës për Ballkanin Perëndimor, gusht 2015, e qasshme në: <https://goog.gl/dsvkuE>

⁵² Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e OJQ në FSHC në Vjenë, Prishtinë, gusht 2017

⁵³ Deklarata përfundimtare e kryesuesit të Samitit të Parisit për Ballkanin Perëndimor, korrik 2016, e qasshme në: <https://goo.gl/fzjtWg>

⁵⁴ Ibid.

⁵⁵ Të gjashtë shtetet rikonfirmuan përkushtimin e tyre lidhur me Traktatin e Komunitetit të Energjisë, të përpiluar në Vjenë. Mirëpo, ato mbesin prapa në zbatimin e ndryshimeve të domodoshme institucionale për një sistem të zbatueshëm rajonal të tregtisë.

⁵⁶ Projektet e transportit: SERBI: Korridori Orient/Lindje-Mesdhe, Interkoneksioni Hekurudhor Cxc: Serbi-Bullgari; SHQIPËRI: Korridori i Mesdheut, Interkonjeksioni Hekurudhor: Mali i Zi - Shqipëri - Greqi; KOSOVË: Korridori Orient/Lindje-Mesdhe, Interkoneksioni Hekurudhor R10: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosovë - Serbi (faza 2), për më tepër shih: <https://goo.gl/nUP71e>

⁵⁷ Korridori Orient/Lindje-Mesdhe (R10), Interkonjeksioni Hekurudhor: Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Kosovë - Serbi, faza e dytë. Faza e dytë e projektit të Kosovës Rruga 10: Fushë Kosovë - Mitrovicë, për më tepër shih: <https://goo.gl/nUP71e>

⁵⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë të Francës, Prishtinë, Paris, 2016

bisedimet e shoqërisë civile në Paris patën shumë më pak ndikim.⁵⁹ Ministri i jashtëm i Austrisë dhe homologu i tij francez refuzuan të merrnin pjesë në forumin e shoqërisë civile.⁶⁰ Megjithë zgjerimin e inicativës rajonale, dhe miratimin e tij nga qeveritë pjesëmarrëse, si zakonisht, pati ngecje në zbatim. Prioritet iu dha ideve të reja për iniciativa rajonale, zbatimi i të cilave vazhdon të mbetet çështje dytësore.⁶¹

ZYRA RAJONALE E BASHKËPUNIMIT RINOR (RYCO)

Samiti i Ballkanit Perëndimor, i mbajtur më 2016 në Paris, themeloi RYCO-n, që është një institucion i pavarur për nxitjen e bashkëpunimit dhe pajtimit mes të rinjve të rajonit, përmes programeve të shkëmbimit të studentëve.⁶² Frymëzimi erdhi nga Zyra e Rinisë Francezo - Gjermane (ZRFGJ), e themeluar pas Luftës së Dytë Botërore, si një mekanizëm pajtues mes Francës dhe Gjermanisë.⁶³ Fokus i RYCO-së është lidhja e rinisë përmes promovimit të pajtimit, bashkëpunimit, mësimit, demokracisë, miqësisë, të kuptuarit dhe ndërkulturalizmit.

Me një buxhet vjetor të planifikuar prej 2 milionë eurove, i cili do të sigurohet nga shtetet e Ballkanit dhe donatorët, RYCO do të përbëhet nga një përfaqësues i qeverisë dhe një përfaqësues i të rinjve nga secili shtet nënshkruar i RYCO-s. Për disa nga shtetet rajonale, zyra përfaqëson vazhdimin e 'shfaqjes' së Vučić dhe Ramës, e krijuar sa për t'ia bërë hatrin BE-së dhe kancelares Merkel.⁶⁴ Procesi ishte mjaft kundërthënës. Por, marrëveshja për RYCO-n ishte arritja më efektive dhe më e prekshme nga Procesi i Berlinit dhe WB6-a. Potenciali është goxha i madh, por edhe pritshmëritë janë të larta. Duke bashkuar rininë, ndërtohen ura dhe perspektiva të pajtimit ndërmjet shteteve.⁶⁵ Shumëkush sugjeron që këtij projekti duhet t'i kushtohet një vëmendje më e madhe.

Mirëpo, proceset e miratimit dhe të përzgjedhjes në disa shtete u përballën me sfida, ngase ato nuk ishin sa duhet gjithëpërfshirëse dhe transparente.⁶⁶ Porceset hasë diskutime të gjata dhe të vështira që sigurohej pranimit i RYCO nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse. Për të siguruar një përfaqësim të barabartë, kryesuesi i RYCO-s është nga Tirana, sekretari i saj i përgjithshëm nga Serbia, zëvendës-sekretari i përgjithshëm është nga Kosova, ndërkohë që përfaqësuesit e tjerë janë nga Mali i Zi, Maqedonia dhe Serbia. Degët e zyrës do të hapen në të gjitha kryeqytetet e shteteve pjesëmarrëse.

SAMITI I TRIESTES 2017

Italia ishte nikoqire e Samitit të katërt për Ballkanin Perëndimor, që u mbajt në korrik 2017. Me mbajtjen e tij në Trieste, që gjeografikisht është shumë afër me WB6, Italia dëshironte të sinjalizonte një lloj pronësie më të madhe të shteteve të Ballkanit Perëndimor ndaj Procesit të Berlinit. Në Trieste u aprovua një projekt për Maqedoninë, dy projekte për Serbinë dhe katër projekte për BeH-në, për të cilat BE-ja zotoi 535.8 milionë euro, dhe dha 194.1 milionë euro.

⁵⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e OJQ në FSHC në Paris, Prishtinë, gusht 2017

⁶⁰ Ibid.

⁶¹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një diplomat të lartë perëndimor, Prishtinë, gusht 2017

⁶² Për RYCO, Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit Rinor, 2017: RYCO do të mbështes shkëmbimet e individëve dhe grupeve të të rinjve nga rajoni, siç janë mësimit praktike, shoqërimet, trajnimet dhe stërvitjet e praktikantëve, ose shkëmbimet grupore, si vizitat studimore, seminarët, punëtoritë, etj, e qasshme në: <https://goo.gl/EWXDKC>

⁶³ RYCO, korrik 2017; "Zyra e Rinisë Francezo-Gjermane do të ofrojë asistencë teknike për Grupin e Punës", e qasshme në: <https://www.fgyo.org/>

⁶⁴ Intervistë e Grupit për Ballkan me anëtarë të shoqërisë civile, Prishtinë, korrik 2017

⁶⁵ Intervista të Grupit për Ballkan, Prishtinë, gusht 2017

⁶⁶ Ibid.

Kosova dhe Shqipëria nuk prezantuan asnjë projekt⁶⁷, gjë që sinjalizoi një mungesë përgatitjeje⁶⁸ - që të dy qeveritë kaluan nëpër një krizë të ashpër politike në vendet e tyre, dhe nëpër disa raunde zgjedhjesh.

Samiti i Triestes u fokusua intensivisht në bashkëpunimin ekonomik dhe të transportit. Agjendat e infrastrukturës funksionale dhe të sektorit të energjisë mbesin dy objektivat kryesore të Procesit të Berlinit. Samiti miratoi Strategjinë Rajonale për Prodhim të Qëndrueshëm të Hidro-energjisë në Ballkanin Perëndimor. Për shkak të karakteristikave topografike dhe hidrografike, sektori i hidro-energjisë ka një rol të rëndësishëm në kontributin ndaj energjisë së ripërtëritshme. Hidrocentrale të reja, aq shumë të nevojshme, mund të ndërtohen në të gjithë rajonin.

Një moment historik i arritur në Samitin e Triestes, është marrëveshja për krijimin e Zonës Ekonomike Rajonale (ZER).⁶⁹ Ajo synon të mënjanojë pengesat brenda WB6-s dhe t'i ndihmojë shtetet në përmbushjen e kriterëve ekonomike të BE-së. Palët u pajtuan që të zbatojnë rregullat e tregtisë, investimit, mobilitetit dhe të dimensionit digjital të BE-së. WB6-ës i mbetet të vendosë për afatin e zbatimit të këtij projekti.⁷⁰ Gjithashtu, Presidenca e BE-së dhe e Komisionit Evropian, bashkë-nënshkruan me shtetet pjesëmarrëse Traktatin e Komunitetit të Transportit (TKT). Kjo gjë është veçanërisht e rëndësishme për Kosovën, sepse paraqet traktatin e parë bilateral të nënshkruar me BE-në dhe me Komisionin Evropian.

ZONA EKONOMIKE RAJONALE

Bashkëpunimi Rajonal dhe Rritja Ekonomike ishin në qendër të diskutimeve në Trieste. Shtetet pjesëmarrëse u pajtuan me Planin Shumëvjeçar të Veprimit për themelimin e ZER.⁷¹ Komisioni do të ndihmojë zbatimin e kësaj iniciative përmes një pakoje prej 7 milionë eurove, të parapara për përmirësimin e klimës së investimeve, strategjitë e specializimit sipas specifikave, dhe për Forumin e Dhomave të Investimit të WB. Po ashtu, nga Komisioni Evropian janë ndarë edhe 48 milionë euro shtesë për Objektivin për Zhvillimin e Ndërmarrësisë dhe Inovacionit për WB6.⁷²

Çështjet bilaterale mes shteteve të WB6-s, kanë qenë gjithmonë pengesë për çfarëdo iniciative rajonale të bashkëpunimit, pavarësisht se sa profitabile mund të jenë dukur ato. Zyrtarët e Qeverisë së Kosovës theksuan se bashkëpunimi ekonomik në rajon nuk mund të ndodhë pa ndihmën e BE-së, kështu që rezultatet mbetet të shihen.⁷³ Objektivat e ZER janë inkurajimi i investimeve, rritja efektive, bizneset fillestare, dhe zhvillimi i ekonomive të të gjithë rajonin. Komponentët e ZER, janë: tregtia, investimet, mobiliteti, dhe integrimi digjital.

- I. **Tregtia:** Qarkullimi i mallrave dhe shërbimeve pa pengesa; harmonizimi i parimeve të Marrëveshjes për Tregti të Evropës Qendrore (CEFTA) dhe i standardeve të BE-së; kosto më të ulëta tregtare.

⁶⁷Projektet e energjisë; Interesi i Komunitetit të Energjisë: Interkonjeksioni Serbi-Bullgari

Projektet e Transportit: Korridori i Mesdheut: Interkonjeksioni rrugor I, Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci Cvc (Segmenti Ponirak-Vraca/Zenica Tunel); Korridori i Mesdheut: Interkonjeksioni rrugor II, Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci Cvc I (Segmenti Tuneli Zenica – Donja Gracanica) Korridori i Mesdheut: Interkonjeksioni rrugor III, Bosnjë e Hercegovinë – Kroaci Cvc (Segmenti Kryqëzimi Johovac – Kryqëzimi Rudanka); Korridori Rhine/Danub: Lidhja ujore, Bosnjë e Hercegovinë – Serbi – Kroaci; Korridori Orient/Lindje – Mesdhe: Interkonjeksioni hekurudhor, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë – Bullgari CVIII; Korridori Orient/Lindje-Mesdhe; Interkonjeksioni hekurudhor, Serbi – Bullgari CXc; për më tepër shih: <https://goo.gl/wGyLw>

⁶⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

⁶⁹ Samiti i Triestes për Ballkanin Perëndimor. Deklarata e kryesuesit italian, korrik 2017, e qasshme në: <https://goog.gl/djIKin>

⁷⁰ Komisioni Evropian, "Ballkani Perëndimor: Zona Ekonomike Rajonale; korniza kohore e themelimit të ZER do të varet nga ambicet e rajonit!", korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/EsQvWr>

⁷¹ Komisioni Evropian, "Samiti për Ballkanin Perëndimor 2017: arritjet për rajonin", korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/v43tfs>

⁷² Ibid.

⁷³ Intervistë e Grupit për Ballkan me një këshilltar strategjik, Dhoma Ekonomike e Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

- II. **Investimet:** Rritja e joshjes së investimeve në rajon; përmes përdorimit të instrumenteve të përshtatshme ligjore për zbatim; monitorimi i reformave të investimeve.
- III. **Agjenda e Mobilitetit:** Ofrimi i mundësive më të mira për profesionistë të kualifikuar (sidomos për mjekë dhe inxhinierë), për hulumtues dhe studentë; nëpërmjet marrëveshjeve me interes të përbashkët.
- IV. **Integrimi Digjital:** Lidhje më të mira sa i përket qasjes digjitale; siguria në shërbimet digjitale; ekonomia digjitale dhe shoqëria digjitale. Kjo agjendë e promovon integrimin e WB6-s në tregun digjital evropian.

Zbatimi i Planit Shumëvjeçar të Veprimit për themelimin e ZER, kërkon një bashkëpunim të autoriteteve kombëtare dhe të strukturave ekzistuese rajonale. Duke marrë parasysh faktin se negociatat në CEFTA nuk prodhuan rezultate shumë frytdhënëse, skepticizmi ndaj funksionalizimit të ZER është i madh.⁷⁴ Plani parashikon që zbatimi të ndodhë mes viteve 2017 dhe 2020, me disa aktivitete që zgjasin deri në vitin 2023.⁷⁵ Themelimi i ZER kërkon aprovimin e shteteve individuale. Në mënyrë që iniciativa të jetë funksionale, shtetet individuale duhet të zgjidhin mospajtimet kufitare dhe të lirohen nga pengesat e vizave, të cilat ende mbesin në qendër të mospajtimeve në rajon. Supozimi se iniciativa ekonomike rajonale do t'i zgjidhë çështjet e pazgjidhura bilaterale, është thjesht vetëm një premtim i rrejshëm. Si çdo projekt tjetër rajonal, edhe ZER ka shumë gjasa të mbetet i bllokuar nga kontestet bilaterale ndërmjet shteteve fqinje.

Shtetet pjesëmarrëse kanë pikëpamje të kundërta rreth kësaj iniciative. Ideja për bashkimin ekonomik rajonal u shty përpara nga Vučić, i cili deklaroi se këtë ide tashmë e ka diskutuar me kryeministrat e Shqipërisë dhe të BeH-së. Ai theksoi se: "Sa më të pasura që të jenë të gjitha shtetet rajonale, aq më mirë do të jetë për të gjithë ne".⁷⁶ Të tjerët ishin të shpejtë në kundërshtimin e iniciativës; ata e etiketuan atë në mënyrë kontraverse, si "Jugosllavia plus Shqipëria". Mali i Zi, i cili është shumë më përpara në përmbushjen e kritereve legale të anëtarësimit, ishte kundër kësaj iniciative.⁷⁷ Një prej skeptikëve ishte edhe kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, i cili në faqen e tij në Facebook shkroi: "Ne nuk e shohim këtë propozim me entuziazëm, sepse nuk duam përvojat e kaluara me paketim të ri".⁷⁸ Kosova dyshonte në synimet e Beogradit për krijimin e një tregu të përbashkët rajonal. Megjithatë ata negociuan një formë bashkëpunimi ekonomik rajonal më të qetë me të cilën u pajtuan të gjitha shtetet. Sido që të jetë, për Kosovën ishte më mirë që të jetë brenda sesa të mbetet jashtë, pohoi një zyrtar i shoqatës së bizneseve.⁷⁹ Po të zbatohet bashkëpunimi ekonomik, Kosova do të përfitonte në fushat e mobilitetit, njohjes së diplomave dhe tregtisë.⁸⁰ Me debate e rezerva- gjashtë vendet diskutuan në mënyrë të vazhdueshme dhe u pajtuan për një formë të caktuar të kësaj iniciative.

⁷⁴ Intervistat e Grupit për Ballkan me zyrtarë qeveritarë të Ministrisë së Financave, Prishtinë, korrik 2017

⁷⁵ Projekti i Konsoliduar i Planit Shumëvjeçar të Veprimit për themelimin e Zonës Ekonomike Rajonale në Ballkanin Perëndimor.

⁷⁶ B92, "Serbia nuk është një oborr pas shtëpie për Evropën, por është dhomë e saj e ndejës", shkurt 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/rko3Jd>

⁷⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

⁷⁸ Intellnews, "Gjashtë liderët e Ballkanit Perëndimor pranuan planin për zonën ekonomike rajonale", korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/LFxasx>

⁷⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan, Prishtinë, korrik 2017

⁸⁰ Ibid.

TRAKTATI I KOMUNITETIT TË TRANSPORTIT

TKT-ja duket se është më shumë vazhdimësi e Observatorit të Evropës Juglindore të Transportit (SEETO), të cilin do ta zëvendësojë nga janari i vitit 2018.⁸¹ SEETO është një organizatë rajonale e transportit me seli në Beograd, e themeluar më 11 qershor 2004, që synon integrimin e Rrjetit Gjithëpërfshirës të TEN-T në Ballkanin Perëndimor.⁸² Synim i TKT-së është t'i ndihmojë shtetet e WB6-s që të integrohen në BE, duke krijuar linja ose lidhje transporti më të afërta.⁸³ Për Ballkanin, TKT-ja ofron një rritje të efikasitetit dhe konkurrueshmërisë në transport dhe turizëm, ulje të kostove dhe kohës së udhëtimit, dhe rritje të joshjes për investime.⁸⁴ Për shtetet anëtare të BE-së, ai ofron sisteme të sigurta dhe efikase të transportit, siguri më të mirë rrugore dhe shërbime më të mira transporti për shtetasit e BE-së.⁸⁵

Iniciativat e mëhershme kanë dëshmuar se nuk mjafton vetëm përmirësimi i menaxhimit të kufinjve, përfshirë vizat, njohjen dhe problemet e demarkacionit, për të tejkaluar mospajtimet mes shteteve individuale.

SHOQËRIA CIVILE

Samiti i Vjenës hapi dyert për shoqërinë civile që t'i bashkëngjitej Procesit të Berlinit.⁸⁶ Takimet filluan me iniciativën e përbashkët të Fondacionit ERSTE, Friedrich-Ebert-Stiftung, Institutit Karl Renner dhe të Qeverisë së Austrisë.⁸⁷ Inkorporimi i organizatave joqeveritare (OJQ) paraqet një vlerë të shtuar për Agjendën e Berlinit. Forumi i Shoqërisë Civile përbëhet nga disa elementë për zhvillimin dhe formulimin e propozimeve.⁸⁸

Forumit kontribuoi në themelimin e RYCO-s, që shënon një hap madhor historik në bashkëpunimin dhe përfshirjen e rinisë së WB6-s. Bashkëpunimi ndërmjet shoqërisë civile dhe politikanëve është i domosdoshëm. OJQ-të përpilojnë rekomandime të politikave mbi temat që përfshijnë: sundimin e ligjit, bashkëpunimin rinor, bashkëpunimin rajonal, çështjet bilaterale, mjedisin dhe energjinë, dhe mjedisin biznesor.⁸⁹ Forumi i Shoqërisë Civile mbahet në të njëjtën kohë dhe vend me samitet vjetore të Ballkanit Perëndimor. Ato mbahen një herë në vit, në vende të ndryshme rajonale.⁹⁰

⁸¹ Prishtina insistoi të jetë seli e TKT. Asnjë seli e organizatave rajonale nuk ndodhet në Kosovë. TKT do të përfshijë vetëm shtetet e WB6-së, për dallim nga SEETO që përfshinte edhe Kroacinë.

⁸² SEETO – Observatori Juglindor Evropian i Transportit, për më tepër shih: <https://goo.gl/PZ4aVb>

⁸³ TKT bazohet në raporte progresive të tregjeve transportuese të WB6-s, bazuar në kapitujt relevant të akteve të kërkuara ligjore. Iniciativa synon të harmonizojë legjislacionet kombëtare të WB6-s me këto kërkesa.

⁸⁴ Komisioni Evropian, "Themelimi i Komunitetit të Transportit ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor" – nënshkrimi i Traktatit të Komunitetit të Transportit 2017", 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/ufYiAU>

⁸⁵ Ibid.

⁸⁶ Intervistat e Grupit për Ballkan me anëtarë të shoqërisë civile, Prishtinë, korrik 2017

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ Forumi i Rinisë në Vjenë u fokusua në tre tema kryesore: ndërtimin e një kulture të bashkëpunimit rajonal, lirinë e shprehjes dhe në krijimin e vendeve të punës dhe prosperitetit. Novi Sadi dhe Beogadi ishin nikoqirë të forumeve pas Vjenës, në maj 2016, ku prioritet iu dha: imigracionit, ndryshimeve klimatike, rritjes së energjisë së gjelbër, kontesteve bilaterale dhe bashkëpunimit rinor. Në korrik 2016, Forumi i Shoqërisë Civile në Paris i bashkoi aktivistët nga BE-ja dhe nga OJQ-të e Ballkanit Perëndimor, me qëllim të elaborimit dhe propozimit të politikave, si dhe të adresimit të çështjeve më me presion në Evropë. Në prill 2017, Tirana u bëri thirrje përfaqësuesve të WB6-së që t'i ofrojnë rekomandimet për ambient, energji, ndryshime klimatike, etj. Forumi i Shoqërisë Civile në Trieste u fokusua në rekomandimet e mëtejshme dhe në tema tjera, si rezultat i procesit të konsultimeve online me OSHC-të nga i gjithë Ballkani.

⁸⁹ Seria e Forumeve të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/8BH2nn>

⁹⁰ Takimet vjetore u mbajtën paralelisht me samitet në Berlin, Vjenë, Paris dhe Trieste. Takimet rajonale u mbajtën paralelisht me takimet ndërmjet samiteve, si ato në Beograd, Shkup dhe Tiranë.

Deklarata e Samitit të Triestes për Ballkanin Perëndimor e pranoi shumë më fuqishëm rolin e shoqërisë civile në Procesin e Berlinit dhe në bashkëpunimin rajonal. Deklarata inkurajoi OJQ-të që të përfaqësojnë opinionin publik në mënyrë të pavarur nga institucionet politike dhe nga liderët politikë.⁹¹ Forumi theksoi se shoqëria civile duhet të ketë një ndikim më të madh në përmbajtjen e raporteve të Komisionit Evropian dhe një pjesëmarrje më të madhe në monitorimin dhe vlerësimin e sundimit të ligjit.⁹² Samiti mirëpriti përfshirjen e shoqërisë civile në fushat e demokracisë, lirisë së mediave, varfërisë së burimeve energjitike, mungesës së efikasitetit të energjisë dhe në problemet bilaterale, me fokus të veçantë në regjimin e vizave.⁹³

Sidoqoftë, Procesi i Berlinit nuk mund të jetë i suksesshëm pa mbështetjen e shoqërisë civile.⁹⁴ Përkundër përkushtimit për t'u përfshirë në Procesin e Berlinit, forumet e shoqërisë civile kryesisht japin rekomandime përgjithëse, duke shmangur adresimin e çështjeve specifike dhe të vështira.⁹⁵ Përfaqësuesi i OJQ-ve nga Kosova theksoi se: "Struktura e forumeve të shoqërisë civile është e koklavitur; ajo nuk na lejon të bëjmë rekomandime për çështjet të cilat na shqetësojnë, përfshirë këtu mobilitetin e rinisë kosovare dhe mosmarrëveshjet bilaterale me Serbinë. Në fakt, ajo paraqet një grumbull rekomandimesh pësuese që nuk janë të dobishme për askënd".⁹⁶ Edhe anëtarët e OJQ-ve nga Maqedonia dhe Mali i Zi shprehën shqetësime të ngjashme. Përfaqësuesit e shoqërisë civile pohojnë se kolegët nga vendet e tyre nuk janë të përfaqësuar në mënyrë të drejtë, dhe se forumi kryesisht udhëhiqet nga fondacionet partnere austriako-beogradase.⁹⁷ I udhëhequr nga Fondi Evropian për Ballkanin, Forumi i Shoqërisë Civile i fton përfaqësuesit e shoqërisë civile përmes një ftese të hapur. Shumë anëtarë me ndikim të shoqërisë civile nuk janë të kënaqur me procesin e aplikimit online. Një sfidë tjetër për Forumin e Shoqërisë Civile është financimi, meqenëse shumë pak donatorë janë të gatshëm që t'i financojnë aktivitetet e OJQ-ve që zhvillohen brenda Procesit të Berlinit.⁹⁸

Shoqëria civile në Kosovës është aktive, e pavarur dhe e përfshirë brenda vendit. Megjithatë, ajo nuk arriti të ishte më e zëshme në FSHC. Për shkak të mungesës së një strukture të caktuar, e cila do të nxiste llogaridhënien ndërmjet insitucioneve politike dhe OJQ-ve, ekziston një mungesë e bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy të fundit.⁹⁹ Kjo gjë reflektohet në Forumet e Shoqërisë Civile.¹⁰⁰ Mosmarrëveshjet bilaterale mbeten të lëna në hije nga prodhimi i rekomandimeve të përgjithshme strategjike. Në mesin e fushave në të cilat OJQ-të e Kosovës u ndjenë të diskriminuara, ishte edhe shtylla e "Mobilitetit të Rinisë", përfshirë këtu edhe çështjen e udhëtimit të lirë të kosovarëve në gjithë shtetet e WB6-s. Në Kosovë, OJQ-të kanë frikë se Serbia do të vazhdojë me bllokimin e projekteve për Kosovën, të cilat do të diskutohen në raundin e parë të projekteve të RYCO-s, në tetor të vitit 2018.¹⁰¹

⁹¹ Deklarata e Samitit të Triestës për Ballkanin Perëndimor nga kryesuesi italian, korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/P3stej>

⁹² Forumi i Shoqërisë Civile i Serisë së Samitit për Ballkanin Perëndimor – Rekomandimet e Forumit të Shoqërisë Civile, si pjesë e Deklaratës së Samitit për Ballkanin Perëndimor, korrik 2017; FSHC preku disa çështje të caktuara të cilat vazhdojnë ta shqetësojnë Ballkanin Perëndimor në rrugën e tij drejt integritimit në BE, e qasshme në: <https://goo.gl/EFwZCA>

⁹³ Përfundimet e Forumit bashkë me përgjigjet e mundshme karshi një qasjeje më strategjike ndaj Procesit të Berlinit, menaxhimi i çështjeve të imigracionit dhe roli i Mbretësisë së Bashkuar në Ballkan, pas BREXIT.

⁹⁴ EcoDev, "Raporti nga Dita 1 e Forumit të Shoqërisë Civile në Trieste", korrik 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/V3Ypzs>

⁹⁵ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e OSHC-ve në FSHC në Trieste, Prishtinë, gusht 2017

⁹⁶ Ibid.

⁹⁷ Ibid.

⁹⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një aktivist të shoqërisë civile me seli në Beograd, Berlin, tetor 2017

⁹⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan, me një anëtar të shoqërisë civile, Prishtinë, korrik 2017

¹⁰⁰ Ibid.

¹⁰¹ Ibid.

Nuk ka dyshim se përfshirja e shoqërisë civile në Deklaratën Zyrtare të Samitit të Triestes paraqet sukses. Megjithatë, projektet e Forumit të Shoqërisë Civile janë të fragmentuar dhe të pjesshëm, ndërkohë që disa janë të nën-përfaqësuar. Institucionet kryesore të financimit të Forumit të Shoqërisë Civile janë institucionet austriake. Forumi nuk ka arritur që t'i përfshijë në mënyrë të barabartë të gjithë aktorët e shoqërisë civile nga secili shtet. Këto pengesa jo vetëm që po pengojnë bashkëpunimin ndërmjet përfaqësuesve pjesëmarrës, por edhe nuk kanë lënë hapësirë për ndryshimin e vetë strukturës së Forumit të Shoqërisë Civile.

2. ÇFARË NËNKUPTON PROCESI I BERLINIT PËR KOSOVËN?

BE-ja ka për qëllim që të trasojë rrugën për bashkëpunime të ardhshme mes WB6-s, pa pasur nevojë për ndihmë evropiane.¹⁰² Procesi po tregohet shumë i ngadalshëm, megjithëse ka disa shenja pozitive. Procesi i Berlinit ofron një mundësi të mirë që Kosova të ketë përfaqësim të barabartë nëpër samite, projekte dhe diskutime. Por, mosmarrëveshjet e pazgjidhura bilaterale, bllokada e Serbisë dhe mungesa e marrëdhënieve me BeH-në, vazhdojnë ta pengojnë pjesëmarrjen e plotë të Kosovës në rajon dhe më gjerë. Sfidat e tjera kanë të bëjnë me paqëndrueshmërinë politike brenda vendit dhe me mungesën e koordinimit ndërmjet institucioneve qeveritare. Kosova duhet të jetë më e zëshme dhe më aktive në të gjitha iniciativat rajonale, përfshirë Procesin e Berlinit.

PËRFITIMET

- Kosova ka mundësinë që t'i dëgjohet zëri dhe që të bashkëpunojë me shtetet e rajonit dhe me BE-në në kushte barazie; qeveritë e WB6-s janë të barabarta në tryezën e negociatave.¹⁰³
- Flamuri i Kosovës vendoset në secilin forum, njësoj sikurse edhe flamujt e shteteve tjera fqinje.¹⁰⁴
- Procesi i Berlinit shënon përparim në bashkëpunimin ndërmjet qeverive të BP-së. Për herë të parë, liderët janë në gjendje të diskutojnë dhe të bëjnë kompromise për çështje të ndryshme.¹⁰⁵
- Gjatë samiteve të Berlinit, Vjenës dhe Parisit, Kosova u paraqit me asteriks, që simbolizonte statusin neutral. Për herë të parë, Kosova nuk u përfaqësua me asteriks në Trieste. Ky hap pozitiv mund të hapë rrugën që kjo të kthehet në praktikë.¹⁰⁶
- Kosova është pjesë e iniciativave më të gjera të kombinimit Berlin-Bruksel.
- Kosova iu bashkua TEN-T-s, që ka ndikim të madh në rrjetin rrugor të Kosovës, sepse përmirëson lidhshmërinë e saj. Ky rrjet e fut Kosovën në rrjetin evropian të transportit.¹⁰⁷
- TKT-ja e nënshkruar në Samitin e Triestes, si vazhdim i SEETO-s, jo vetëm që e rendit Kosovën me emrin e saj, por edhe e bën atë kandidatë potenciale për zyrën rajonale të TKT-së.¹⁰⁸ Sipas SEETO-s, organizatë rajonale e transportit e nënshkruar në vitin 2004 nga WB6-a dhe Kroacia, Kosova renditej si "Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë".

¹⁰² Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar në Ministrinë e Financave, Prishtinë, korrik 2017

¹⁰³ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

¹⁰⁴ Ibid.

¹⁰⁵ Ibid.

¹⁰⁶ Ibid.

¹⁰⁷ Radio Evropa e Lirë, "Marrëdhëniet e këqija kërcënojnë projektet e autostradave dhe hekurudhave në rajon, ministri i Kosovës për Infrastrukturë: "Kosova është e barabartë me shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor", shtator 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/YHnQ5D>

¹⁰⁸ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të Ministrisë së Transportit, Prishtinë, gusht 2017

- Kosova është anëtare nënshkruese e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor. Zëvendëssekretari i përgjithshëm i RYCO është nga Kosova.¹⁰⁹
- Kosova do të përfitonte po qe se do të zbatohet Zona Ekonomike Rajonale, në veçanti sa i përket kritereve për viza, njohjes së autoriteteve të Kosovës, certifikatave të lindjes, licencave, diplomave dhe shkëmbimit të profesionistëve.
- Nëpërmjet Procesit të Berlinit dhe të iniciativave të tjera rajonale, Kosova përmbush detyrimet e MSA-së për marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimin rajonal.¹¹⁰

SFIDAT

- Kosova përballlet me sfida të mëdha gjatë promovimit të shtetësisë së saj dhe nxitjes së bashkëpunimit rajonal, përfshirë këtu edhe Procesin e Berlinit dhe agjendën e anëtarësimit në BE.
- Bashkëpunimi rajonal shpesh i fsheh nën qilim mosmarrëveshjet bilaterale, ndaj si rrjedhojë, Kosova vuan më së shumti për shkak të mosmarrëveshjeve të saj bilaterale me Serbinë dhe BeH-në. Edhe pse ka tendenca pozitive, që dolën nga Procesi i Berlinit, çështjet më të rëndësishme për Kosovën mbeten të pazgjidhura. Në mesin e tyre janë mohimi i shtetësisë së Kosovës, demarkacioni i kufijve dhe pjesëmarrja e plotë dhe e lirë në iniciativat dhe projektet rajonale, të bllokuara kryesisht nga Serbia.
- Pavarësisht viteve të gjata të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve, mosmarrëveshjet e pazgjidhura bilaterale vazhdojnë të sfidojnë zbatimin e projekteve dhe rrugën e Kosovës drejt BE-së.¹¹¹
- Faza e tretë e projektit hekurudhor varet nga zgjidhja e mosmarrëveshjes Kosovë-Serbi. Segmenti i hekurudhave në veri të Kosovës nuk financohet për shkak të pretendimeve pronësore dhe territoriale të Serbisë.
- Nuk mund të ketë një bashkëpunim të vërtetë rajonal nëse qytetarët e BeH-s dhe Kosovës nuk mund të udhëtojnë lirshëm dhe nëse qytetarët e Kosovës kanë ende frikë të udhëtojnë në Serbi.¹¹² Mosmarrëveshjet politike ndërmjet Kosovës, BeH-s dhe Serbisë pengojnë bashkëpunimin rajonal, duke ngritur dyshime në suksesin e gjithë procesit, ose të paktën po pengojnë së tepërmi përfitimet e këtij bashkëpunimi.
- Partneriteti në rritje ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë, po bën që udhëheqësit serbë të largohen nga mosmarrëveshja Kosovë – Serbi.¹¹³ Qeveria e Kosovës është e ndjeshme ndaj zëvendësimit të marrëdhënieve Kosovë - Serbi, me marrëdhëniet Serbi - Shqipëri. Është e qartë që Serbia përfiton nga iniciativat rajonale, duke e minimizuar rëndësinë e përmirësimit të marrëdhënieve me Kosovën.
- Kosova është i vetmi shtet pa asnjë seli të organizatave rajonale. Kjo gjë ngre dyshime lidhur me trajtimin e barabartë mes zyrtarëve qeveritarë dhe atyre të shoqërisë civile në Kosovë.
- Kosova ka një ekonomi të vogël, e cila kryesisht mbështetet në import. Nuk ka ndonjë performancë të mirë tregtare në rajon ose me BE-në, dhe kryesisht furnizohet nga eksportet

¹⁰⁹ RYCO – Ekipi i RYCO-së, e qasshme në: <https://goo.gl/XhNp6j>

¹¹⁰ Marrëveshja e Stabilizimit Asocimit mes Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në një të anë, dhe Kosovës në anën tjetër, tetor 2015, neni 8: “Kosova zotohet të vazhdojë të nis bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë në rajon, përfshirë këtu një nivel të duhur të koncesioneve bilaterale sa i përket lëvizjes së njerëzve, mallërave, kapitalit dhe shërbimeve, sikurse edhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët në një sërë fushash, përfshirë sundimin e ligjit. Ky zotim paraqet faktorin kryesor për zhvillimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mes palëve, duke i kontribuar kështu stabilitetit rajonal”, e qasshme në: <https://goo.gl/x7QXoy>

¹¹¹ Intervistë e Grupit për Ballkan me drejtorin ekzekutiv të BPRG, korrik 2017

¹¹² Ekonomia Online, “Marrëdhëniet e këqija kërcënojnë projektet e autostradave dhe hekurudhave në rajon, analisti Naim Rashiti rreth Procesit të Berlinit”, gusht 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/8ZTTrG>

¹¹³ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e OJQ në Vjenë dhe Paris, Prishtinë, gusht 2017

serbe, ndaj zgjerimi i mëtejshëm i tregtisë do ta dëmtonte ekonominë lokale.¹¹⁴

- Kosova është shumë larg fqinjëve të saj në procesin e anëtarësimit në BE.
- Paqëndrueshmëria e brendshme në Kosovë, ka shmangur fokusin nga politikat, projektet dhe agjendat, përfshirë ato të Procesit të Berlinit.¹¹⁵ Institucionet e dobëta dhe planifikimi e koordinimi i dobët i politikave, japin një pasqyrë të keqe të performancës së Kosovës, pra, përgatitja e projekteve, sigurimi i financave dhe avancimi i marrëdhënieve të mira fqinjësore, krijimi i partneriteteve dhe përfitimi i një mbështetjeje më të madhe.
- Është e dukshme që zyrtarëve të Kosovës iu mungon përkushtimi, konsistenca dhe angazhimi në këtë proces. Po ashtu, mungesa e përfshirjes dhe transparencës i lë institucionet të painformuara dhe i bën të ngurrojnë që të përfshihen.

TRANSPORTI

Shtetet pjesëmarrëse i kanë dhënë përparësi Agjendës së Konektivitetit për zhvillimin e bashkëpunimit rajonal. Përgjatë gjithë procesit janë promovuar projekte të infrastrukturës rajonale. Mekanizma të ndryshëm të granteve, përfshirë këtu KE, WBIF, BEI, BOE dhe BEK, zotuan fonde investimi dhe kredi për shtetet përfituese, me qëllim të bashkëfinancimit të projekteve infrastrukturore.¹¹⁶ Në vitin 2015, WB6-a dhe liderët e BE-së u pajtuan që ta integronin WB6 në Rrjetin Themelor dhe në Korridoret e BE-së, si pjesë të TEN-T-së.¹¹⁷ Agjenda e Konektivitetit e Procesit të Berlinit fokusohet në Rrjetin Themelor, megjithëse janë financuar edhe disa projekte të Rrjetit Gjithëpërfshirës.¹¹⁸ Rrjeti Themelor i lidh shtetet e WB6-s me shtetet e BE-së.¹¹⁹ Kjo promovon qarkullimin e mallrave, njerëzve dhe tregtisë. SEETO ka përlllogaritur një kosto të përgjithshme prej 7.7 miliardë eurosh për projektet prioritare të WB6-s.¹²⁰ BE-ja ka zotuar mbi 1 miliard euro, për periudhën 2014 - 2020; mekanizat e granteve kanë ndarë 50% të mjeteve për projekte hekurudhore dhe 20% për projekte të autostradave.¹²¹ Është arritur marrëveshje edhe për një paketë reformash që do jenë në përputhje me standardet e Rrjetit Themelor dhe të Korridoreve. TEN-T është një rrjet që përbëhet nga rrugët, linjat hekurudhore, rrugët e brendshme ujore, portet e brendshme apo ato detare, aeroportet dhe terminallet hekurudhore përgjatë të gjitha 28 shteteve anëtare të BE-së.¹²² Rrjeti përbëhet nga Rrjeti Gjithëpërfshirës dhe nga Rrjeti Themelor. Rrjeti Themelor është pjesë e Rrjetit Gjithëpërfshirës, i cili shquhet për rëndësinë strategjike për rrjedhat më të mëdha të transportit evropian dhe global. Marrëveshja për Rrjetin Themelor të Transportit për Ballkanin Perëndimor, është arritur në vitin 2015¹²³, dhe pritet që ai të përfundojë deri në vitin 2030.¹²⁴

¹¹⁴ Intervistat e Grupit të Ballkanit me zyrtarë qeveritarë të Ministrisë së Financave, Prishtinë, korrik 2017

¹¹⁵ Probleme të ngjashme janë vërejtur edhe në implementimin e MSA-së, Agjendës Evropiane të Reformave, etj.

¹¹⁶ Raporti Vjetor i Kornizës Investive për Ballkanin Perëndimor 2016, i qasshëm në: <https://goo.gl/tr7Cbd>

¹¹⁷ Rrjeti Thelbësor është një rrjet që i lidh kryeqytetet, qendrat ekonomike dhe portet detare.

¹¹⁸ Ibid.

¹¹⁹ Ibid.

¹²⁰ Raporti Vjetor i Kornizës Investive për Ballkanin Perëndimor 2016, i qasshëm në: <https://goo.gl/tr7Cbd>

¹²¹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

¹²² Shiko hartat e TEN-T, në: <https://goo.gl/rvWNyr>

¹²³ Për më shumë informata për OEJLT shih: <https://goo.gl/zWNhJz>

¹²⁴ OEJLT, Plani Shumëvjeçar Zhvillimor për Pesë Vjet, i freskuar më 2016, i qasshëm në: <https://gpoo.gl/uqHJCr>

Kosova përfshihet në të dyja rrjetet, në Rrjetin Themelor dhe atë Gjithëpërfshirës.¹²⁵ R10 është në Korridorin e Rrjetit Themelor të TEN-T. Qeveria e Kosovës ka prezantuar projekte të tjera, përfshirë autostradën Prishtinë - Hani i Elezit. Prosesi i Berlinit dhe institucionet financuese nuk do t'i mbështesin projektet që tashmë janë në zbatim e sipër, ose me kontratë.¹²⁶ R10 lidh Krlevën (Serbi) me Prishtinën (Kosovë) dhe Gorce Petrov (Maqedoni). Projekti është i ndarë në tre faza: Fushë-Kosovë - Kufiri me Maqedoninë, Fushë-Kosovë – Mitrovicë dhe Mitrovicë - Kufiri me Serbinë. Zbatimi i dy fazave të para tashmë ka filluar, ndërsa faza e tretë po pret aprovimin për shkak të mosmarrëveshjeve politike mes Serbisë dhe Kosovës rreth territorit dhe pronës në veri të Kosovës. Dialogu i lehtësuar nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë nuk ka siguruar pajtueshmëinë e Serbisë me ligjet dhe territorin e Kosovës; Beogradi ende ka pretendime për pronat në hekurudha dhe në infrastrukturën tjetër në veri të Kosovës. Ka pak gjasa që faza e tretë të fillojë të zbatohet së shpejti.¹²⁷ Për segmentin e parë të projektit, BERZH ka investuar 80.9 milionë euro (48%); për segmentin e dytë, BERZH dhe BEI kanë investuar 42.3 milionë euro (43%).¹²⁸ Zbatimi i projektit është i ngadalshëm, kryesisht për shkak të mungesës së bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të Kosovës.¹²⁹ Për të përshpejtuar fazat zbatuese, kërkohet një koordinim më i efektshëm ndërmjet Parlamentit, Ministrisë së Infrastrukturës, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë për Integritet Evropian.¹³⁰

Kosova e ka nënshkruar Traktatin e Komunitetit të Transportit në Trieste, i cili e zgjeron TEN-T edhe në Ballkanin Perëndimor. U deshën disa vjet për t'u pajtuar për Komunitetin e Transportit; qeveria ka kundërshtuar hartat që paraqisnin kufirin Kosovë – Serbi me një vijë më të hollë.¹³¹ Përfaqësuesit e Kosovës e miratuan TKT-në me tre kushte. Kosova dorëzoi një letër për mosnjohjen e hartave dhe të kufirit me Serbinë. Po ashtu, ajo kërkoi që shtetet të renditen sipas radhës alfabetike, duke e vendosur kështu Kosovën para Serbisë, dhe kërkoi që selia e TKT-së të vendoset në Prishtinë.¹³²

ENERGJIA

Agjenda e Konektivitetit e Procesit të Berlinit, parasheh Investime në Infrastrukturën Energjetike përmes Kornizës Investive të Ballkanit Perëndimor (WBIF) dhe kredive nga institucionet financiare ndërkombëtare.¹³³ Në prill të vitit 2016, WB6-a nënshkroi një Memorandum të Mirëkuptimit (MiM) mbi zhvillimin e tregut rajonal të energjisë. Vendet u pajtuan që të themelonin një kornizë bashkëpunimi; Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ka kompetencat që t'i asistojë WB6-s në zbatimin e këtyre masave, megjithëse deri më tani ka pasur fare pak zbatim.¹³⁴ Bashkëpunimi energjetik rajonal është penguar nga paaftësia e qeverive për të përmbushur qëllimet e përcaktuara në kornizën e bashkëpunimit. Në Paris u

¹²⁵ Rrjeti Thelbësor për Kosovën përfshinë: Rrugën 6a, Prishtinë (KOS) – Shkup (MKD) dhe Rrugën 7, Lezhë (ALB) – Prishtinë (KOS) – Doljevac (SER). Rrjeti Gjithëpërfshirës përfshinë: Rrugën 6a, Ribarevina (MNE) – Ribarice (SER) – Prishtinë (KOS) – Shkup (MKD), Rrugën 6b, Prishtinë (KOS) – Pejë (KOS) – Kolasin (MNE), dhe Rrugën 6, Lezhë (ALB) – Prishtinë (KOS) – Doljevac (SER), shih në: <https://goo.gl/uqHJCr>

¹²⁶ Intervistë e Grupit për Ballkan me përfaqësuesin e OJQ në FSHC në Vjenë dhe Paris, Prishtinë, gusht 2017

¹²⁷ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

¹²⁸ Agjenda e Konektivitetit – Bashkëfinancimi i projekteve investive në Ballkanin Perëndimor 2015 dhe 2016, i qasshëm në: <https://goo.gl/z155wN> dhe <https://goo.gl/nUP71e>

¹²⁹ Ministria e Infrastrukturës e vonon zbatimin, insiston në një studim të ri të fizibilitetit i cili do të planifikonte rindërtimin e hekurudhës në qytetin e Ferizajt. BE-ja dhe institucionet financiare nuk e mbështetën këtë iniciativë. Debatet që ende vazhdojnë dhe pamundësia e qeverisë për të vendosur shpejtë e kanë vonuar implementimin për një vit.

¹³⁰ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar në Ministrinë e Infrastrukturës, Prishtinë, korrik 2017

¹³¹ Zyrtarët kosovarë kërkuan harta të reja. Por, ndërrimi i hartave të TEN-T-së është pothuajse i pamundur, sepse kërkon miratimin e 28 shteteve anëtare të BE-së, përfshirë këtu pesë shtetet që s'e kane njohur pavarësinë e Kosovës, Intervistë e Grupit për Ballkan, Bruksel, maj 2017

¹³² Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, Prishtinë, korrik 2017

¹³³ Fondacioni i Gjellbër i Ballkanit, "Pasqyrë e Energjisë së Ballkanit", qershor 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/tfSfkq>

¹³⁴ Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim/ShtetWeb, "Monitorimi i Procesit të Berlinit: Nga Parisi deri në Trieste", janar 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/hBgdY3>

nënshkrua edhe një MiM për tregtinë ndërkufitare të energjisë elektrike. Në Paris u miratua edhe udhërrëfyese për tregun e përbashkët rajonal të energjisë.¹³⁵ Qeveritë e WB6-s ende po lëvizin ngadalë për krijimin e një tregu të organizuar për tregtimin efektiv të energjisë elektrike. Kosova ka ngecur prapa me projekte në sektorin e energjisë. Marrëveshja për energjinë me Serbinë nuk është zbatuar.¹³⁶ Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (KOSTT) ka refuzuar të nënshkruajë një MiM-in e dakorduar mes shteteve WB6-s¹³⁷, për shkak të mospërputhjes së Serbisë me marrëveshjen e arritur me ndërmjetësimin e Brukselit për energjinë.¹³⁸ Beogradi qëllimisht po e vonon zbatimin e marrëveshjes për energjinë dhe po heziton që t'ia lejojë Kosovës që të fusë plotësisht nën kontroll rrjetin e saj elektrik. Një diplomat perëndimor e pranon: "Kam frikë se Beogradi nuk është i interesuar që ta zbatojë marrëveshjen për energjinë".¹³⁹ Paradoksi është se qeveria gjermane dhe BE-ja nuk janë të gatshme që ta bindin Serbinë për ta zbatuar marrëveshjen, përkundër investimeve të tyre të mëdha në sektorin energjetik në Kosovë.¹⁴⁰ DG NEAR i BE-së heziton edhe më shumë që të shtyjë zbatimin e kësaj marrëveshjeje.¹⁴¹ Qeveria gjermane ka investuar rreth 80 milionë euro në sektorin energjetik të Kosovës, përfshirë këtu edhe linjën e re prej 400 MW, që shtrihet mes Kosovës dhe Shqipërisë.¹⁴² Bllokada e Serbisë ndaj antarësimit të Kosovës në Komunitetin e Energjisë me seli në Vjenë, u kushton miliona euro operatorëve të energjisë në Kosovë.¹⁴³ Autoritetet e Kosovës nuk mund ta kontrollojnë transmisionin e energjisë dhe të integrojnë ENTSO-E.¹⁴⁴ Këto çështje po e frustrojnë Qeverinë e Kosovës, dhe po kontribuojnë në rritjen e indinjatës së qytetarëve të Kosovës ndaj dialogut Kosovë-Serbi.

BASHKËPUNIMI EKONOMIK RAJONAL

Qëllimi është fillimi i reformave ekonomike sipas standardeve të BE-së. Liderët politikë të Kosovës nuk e mirëpritën iniciativën për një treg të përbashkët. Megjithatë, qeveria pranoi që të negocionte një formë tjetër të bashkëpunimit ekonomik rajonal. Pas samitit, kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, deklaroi se: "Kosova synon të jetë pjesë e tregut evropian, por kjo duhet të bëhet vetëm përmes bashkëpunimit ekonomik me Ballkanin Perëndimor. Por, tregu i përbashkët s'mund të funksionojë pa një lëvizje të lirë dhe pa liberalizim për kosovarët".¹⁴⁵ ZER ishte një kompromis i arritur në minutën e fundit.¹⁴⁶ Shtetet pjesëmarrëse kishin pikëpamje

¹³⁵ Nënshkrimi i MiM përcaktoi udhërrëfyesin, megjithëse tregtia ndërkufitare e energjisë mbetet vetëm një potencial i rajonit. Nënshkrimi i udhërrëfyesit për treguesin e energjisë elektrike të rajonit, që u nënshkrua në Samitin e Parisit, synonte të shtynte përpara implementimin e masave të pranuar paraprakisht. Kushtet kryesore për implementimin e spot tregtisë siç nënvizohet në udhërrëfyes janë:

¹³⁶ Përfundimet e lehtësuesit të BE-së mbi implementimin e Marrëveshjes për Energji të vitit 2013, shtator 2013, i qasshëm në: <https://goo.gl/NmmHeh>

¹³⁷ Memorandumi i Mirëkuptimit mes shteteve të WB6-s mbi Përforcimin e Integritimit të Tregut Rajonal të Energjisë Elektrike.

¹³⁸ KOSTT Shpk ose ndryshe Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës, është një kompani publike, për më tepër shih: <https://goo.gl/Nyqkpc>

¹³⁹ Serbia po e shkelë marrëveshjen e energjisë, duke mos i regjistruar dy kompani energjetike sipas ligjeve të Kosovës. Implementimi i marrëveshjes mes KOSTT dhe Rrjetit Evropian të Sistemit të Transmisionit të Operatorëve të Energjisë Elektrike, që përfaqëson 43 operatorë të sistemit të transmisionit të energjisë (OTSE) nga 36 shtete të gjithë Evropës, shih në: <https://goo.gl/vpvMJx>

¹⁴⁰ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtarë qeveritarë, dhe zyrtarë të KOSTT, Prishtinë, gusht 2017,

¹⁴¹ "Ne nuk jemi lojtarët kryesorë në këtë, EEAS dhe shtetet anëtare e kanë shtyrë këtë punë", intervistë e Grupit të Ballkanit me një zyrtarë të BE-së, Prishtinë, gusht 2017

¹⁴² Reporter.al, "Vijat e Interkonekcionit Shqipëri-Kosovë janë bllokuar për kohë të pacaktuar", mars 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/TUyT7D>

¹⁴³ Intervistë e Grupit për Ballkan me zyrtarë të KOSTT, Prishtinë, gusht 2017

¹⁴⁴ Serbia duhet të votojë për anëtarësimin e Kosovës në ENTSO-E. Ministri kosovar për Dialog dhe negociatori kryesor deklaroi se, nëse vonesat vazhdojnë, Kosova do të jetë e obliguar të aplikojë masa reciproke kundër Serbisë, për të mbrojtur pavarësinë e saj në sistemin e energjisë. Derisa të dyja palët dhe BE-ja të mos gjejnë një zgjidhje për këto çështje, zhvillimi i mëtutjeshëm i sektorit të energjisë do të jetë vështirë i arritshëm. Prishtina Insight, "Kosova refuzon të nënshkruaj memorandumin e energjisë për Ballkanin Perëndimor", prill 2016, i qasshëm në: <https://goo.gl/gT18D7>

¹⁴⁵ Koha.net, "Kosova nuk pranoi një treg të përbashkët në Ballkanin Perëndimor", mars 2017, i qasshëm në: <https://goo.gl/dpobHw>

¹⁴⁶ Shtetet e WB6-s kanë nivele të ndryshme të dyshimeve mbi rritjen ekonomike. Deri më tani, negociatat në CEFTA mes

kundërshtuese për këtë iniciativë. Temat e reja të cilat i trajton ZER-i përfshijnë heqjen e dokumentacionit burokratik, njohjen e certifikatave dhe diplomave, dhe mobilitetin e fuqisë punëtore (në veçanti të mjekëve dhe inxhinierëve). Ideja e ZER-it është pozitive, por realizimi i saj është shumë më kompleks nga sa mendohej.

MOSMARRËVESHJET BILATERALE

Krerët e qeverive u pajtuan që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet bilaterale në fazën e hershme të procesit të anëtarësimit në BE.¹⁴⁷ Vendet e WB6-s u zotuan fuqishëm se nuk do t'i bllokojnë ose dekurajojnë shtetet e tjera në rrugëtimin e tyre drejt BE-së. Mirëpo, në këtë drejtim është arritur pak ose aspak. Në vend të kësaj, në dy vitet e fundit tensionet mes qeverive dhe incidentet përbrenda shteteve kanë qenë jashtëzakonisht të shpeshta. Samitet e Procesit të Berlinit nuk arritën të adresojnë mungesën e përparimit në këtë pikë të agjendës.

Çështjet mes shteteve mbesin ende të pazgjidhura, megjithëse ato akoma nuk i prijnë listës së prioritetëve të Agjendës së Berlinit. Mosmarrëveshjet e tilla përfshijnë marrëdhënie të dobëta bilaterale, përndjekjen e krimeve të luftës, statusin e pakicave, kontestet gjyqësore, personat e zhdukur dhe riatdhesimin dhe riintegrimin e personave të zhvendosur.¹⁴⁸ Ombrella e bashkëpunimit rajonal duhet t'u japë përparësi marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Në praktikë, Kosova është ajo që vuan më së shumti; Serbia dhe BeH-ja e sfidojnë sovranitetin dhe pavarësinë e Kosovës. Bllokada e Serbisë vazhdon të jetë pengesë për integrimin e Kosovës në ENTSO-E.¹⁴⁹ Ambienti i brendshëm politik në BeH reflekton keq në marrëdhëniet me shtetet e WB6-s, e në veçanti me Kosovën. Iniciativa për zgjidhjen e çështjeve bilaterale mbetet në duart e qeverive të Ballkanit Perëndimor; nuk ka gjasa që kjo situatë të ndryshojë në një të adhme të afërt. Mbështetja e BE-së për bashkëpunimin rajonal nuk mjafton; BE duhet të kërkojë që zgjidhja e çështjeve bilaterale t'i paraprijë bashkëpunimit rajonal dhe anëtarësimit në BE.¹⁵⁰

Dështimi i Qeverisë së Kosovës që të ratifikojë marrëveshjen kufitare me Malin e Zi, mbetet një çështje që reflekton tensionet politike në vend, por edhe paaftësinë e saj që të përmbyllë marrëveshjet e arritura me fqinjët. Krahas konsolidimit të shtetit, Kosova duhet të punojë në përmirësimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore. Në mungesë të progresit në raport me Serbinë, Prishtina duhet të punojë me Maqedoninë, Shqipërinë dhe Malin e Zi, për të maksimizuar përfitimet nga Procesi i Berlinit.

3. PARA SAMITIT TË LONDRËS: KU PO SHKON PROCESI?

Në korrik 2018, Mbretëria e Bashkuar (MB) do të jetë nikoqire e Samitit për Ballkanin Perëndimor. Është ironike që një shtet i cili qëllimisht po largohet nga BE-ja, të jetë nikoqir i një samiti që WB6-s i cili hap rrugë për integrim në BE. Me BREXIT, Ballkani Perëndimor humbi një avokat të fuqishëm brenda BE-së. Së bashku me Berlinin, qeveria britanike ishte një prej kombeve kryesore që i ushtroi presion Serbisë për të shtyrë përpara dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën.¹⁵¹ Madje, edhe pas BREXIT, MB mbeti një aktor i rëndësishëm

shteteve të WB6-s janë treguar të pasuksesshme dhe kaotike. Një version i ri i CEFTA's ngre dyshime tek liderët politikë të Kosovës.

¹⁴⁷ Bashkëpunimi rajonal dhe hapja e kontesteve bilaterale janë futur si parime të përgjithshme të Marrëvesjes së Stabilizimit Asocimit (MSA)

¹⁴⁸ Fondi Evropian për Ballkanin, "Procesi i Berlinit dhe Bashkëpunimi Rajonal në Ballkanin Perëndimor: Si të bëhet marrëveshja më efektive dhe më efiçente?", dhjetor 2016, e qasshme në: <https://goo.gl/9cEf3W>

¹⁴⁹ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar qeveritar, Prishtinë, korrik 2017

¹⁵⁰ Intervistë e Grupit për Ballkan me një zyrtar të MB, gusht 2017

¹⁵¹ MB dhe Gjermania do të lëshojnë demarshe të shpeshta dhe dokumente informative joformale për qeverinë e Serbisë. Shih

në Ballkanin Perëndimor. Qeveria e MB-së i ka intensifikuar vizitat e nivelit të lartë në rajon dhe ka riformatuar politikat e Ballkanit Perëndimor. Agjenda e Samitit të Londrës është ende në përgatitje e sipër, por qëllimi kryesor i tij do të jetë sigurimi i partneritetit dhe i kontrollit të qeverive të WB6-s ndaj procesit.¹⁵² Ecuria e agjendave aktuale është qenësore për të siguruar vazhdimin e të arriturave. Kjo nuk nënkupton sjelljen e ideve të reja në tavolinë, të cilat do t'ua humbnin rëndësinë pikave të agjendave aktuale, por fokusimin dhe elaborimin e monitorimit dhe vazhdimësinë e të arriturave nga samitet e kaluara.¹⁵³ Ngjashëm, edhe radhitja e prioriteteve të Agjendës së Berlinit ka nevojë të ndryshojë: mosmarrëveshjet bilaterale duhet të jenë shqetësimi i parë. Së bashku me liderët britanikë, kancelarja gjermane Angela Merkel, dhe përfaqësuesja e lartë e EEAS, Federica Mogherini, duhet të kërkojnë një përparim të prekshëm të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve bilaterale mes fqinjëve në Ballkanin Perëndimor. Zyrtarët britanikë kanë deklaruar se, megjithëse MB do të dëshironte që t'i adresonte sfidat e përbashkëta të sigurisë, dhe të ketë ekspertizë për çështje të sigurisë, samiti i vitit 2018 nuk do të ketë prioritet vetëm çështjet e sigurisë.¹⁵⁴ Kur iu drejtua Dhomës së Përfaqësuesve, kryeministrja britanike, Theresa May, deklaroi se MB ka aftësi që të dëshmojë edhe njëherë se Britania do të vazhdojë të luajë roli kryesor në Evropë, edhe pas BREXIT. Përpara samitit, Britania do të shtojë bashkëpunimin në fushën e sigurisë me partnerët nga Ballkani Perëndimor. Kryeministrja May më pas vlerësoi se agjenda do të përfshijë një sërë çështjesh, përfshirë krimin e organizuar, anti-korrupsionin dhe sigurinë kibernetike.¹⁵⁵ Duke qëndruar vazhdimisht e përfshirë në Ballkanin Perëndimor, është strategji e MB-së që të gjejë vendin e saj si shtet i pavarur evropian, pas daljes nga BE-ja.¹⁵⁶

Pritet që Procesi i Berlinit të vazhdojë pas Samitit të Londrës. Edhe pse ende nuk dihet nëse kjo agjendë e re hipotetike do të jetë një vazhdim i procesit apo një mekanizëm i ri, agjenda e samitit duhet të vazhdojë t'i mbajë të hapura kanalet e komunikimit mes WB6-s.

Për të arritur këtë objektiv, duhen fuqizuar marrëdhëniet mes Agjendës së Berlinit dhe iniciativës për Zgjerim të BE-së në Ballkanin Perëndimor. Negociatat për zgjerimin e BE-së mund të kenë përfitim përmes integritit të peshës politike që kanë liderët e Agjendës së Berlinit. Kjo mund të arrihet duke i dhënë rol Agjendës së Berlinit në strategjinë e BE-së për Zgjerim, si dhe Samitit për Ballkanin Perëndimor të vitit 2018.¹⁵⁷ Fuqizimi i Agjendës Berlinit duhet të vazhdojë me zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve bilaterale para anëtarësimit të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor. Duke e bërë këtë, Agjenda e Berlinit mund të promovojë politikën e integritit të Gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian dhe ta ndihmojë atë në zbatimin e disa prej kushteve kryesore.

Raportin e Grupit të Krizave "Serbia dhe Kosova: Rruga drejt Normalizimit", shkurt 2013; "Kosova dhe Serbia: Pak vullnet i mirë do të mund të kishte efekt afatgjatë", shkurt 2012.

¹⁵² Intervistë e Grupit për Ballkan, me një zyrtarë të MB, gusht 2017

¹⁵³ Instituti për Demokraci Societas Civilis, "Drejt më të dukshmes, më efikases dhe më efeçentes: Procesi i Berlinit 2.0", nëntor 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/CSB6aW>

¹⁵⁴ Ibid.

¹⁵⁵ Kryeministrja Theresa May iu adresua Parlamentit në takimin e Këshillit të BE-së të muajit mars, lidhur me hapat e ardhshëm për përgatitjen e nenit 50. Zyra e Kryeministres britanike, "Deklarata e Kryeministres për Këshillin e Evropës: 14 mars 2017", e qashme në: <https://goo.gl/ubcA8U>

¹⁵⁶ Intervistë e Grupit për Ballkan me një ministër të Qeverisë së Kosovës, korrik 2017, dhe Seria e Samitit të Forumit të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, "Çka tutje? Presidencia britanike e Procesi të Berlinit në kohën e BREXIT'it", korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/G4sfjR>

¹⁵⁷ Strategjia e BE-së për Zgjerim do të publikohet në shkurt 2018. Ajo do të caktojë kushtet dhe ritmin për anëtarësim në BE të secilit prej gjashtë shteteve të Ballkanit Perëndimor. Në maj 2018, Sofia do të jetë nikoqire e Samitit BE-Ballkani Perëndimor, që përfaqëson njëloj vazhdimi të Samitit të Selanikut të vitit 2003 për perspektivën në BE.

PËRFUNDIM

Procesi i Berlinit shënon herën e parë ku liderët e WB6-s u pajtuan të ulen së bashku, të bisedojnë dhe të bëjnë kompromise. Ky proces shtoi një dinamikë të re dhe ka potencialin që të përmirësojë marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe WB6-s. Secili samit vjetor e vë theksin në disa çështje të caktuara. Gjermania përcaktoi bazën për të drejtat themelore, Austria u fokusua në mosmarrëveshjet bilaterale, emigracionin dhe në shoqërinë civile, Franca u mor me trajnimet profesionale dhe programet e shkëmbimit të rinjve, ndërkohë që Italia u koncentrua në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.¹⁵⁸

Agjenda e Konektivitetit dhe themelimi i RYCO-s paraqesin të arriturat kryesore të iniciativës së Procesit të Berlinit. Qeveritë e WB6-s janë të barabarta në Procesin e Berlinit. Secili përfaqësues i shtetit është përgjegjës për të fokusuar vëmendjen te projektet e realizueshme për financim potencial. Serbia dhe BeH kanë përfituruar më së shumti nga financimi i projekteve. Megjithëse Kosova fitoi projektin hekurudhor R10, ajo nuk po i përdor maksimalisht mundësitë që ofron procesi.

Procesit të Berlinit do t'i shtohen agjenda të reja. Faza e parë (2014-2018) filloi një set projektesh premtuese, edhe pse vonesat dhe mungesa e zbatimit ndikuan në prodhimin e rezultateve të prekshme; qytetarët e Ballkanit Perëndimor ende nuk po shohin përfitime. Në mesin e dobësive të procesit, janë edhe mungesa e një mekanizmi monitorues dhe mungesa e transparencës nga ana e qeverive. Mekanizmat monitorues dhe kornizat e raportimit të dizajnuara mirë, do të mund të siguronin një zbatim më të mirë. Shoqëria civile në nivelin rajonal duhet të jetë më e përfshirë dhe të zhvillojë mjete dhe politika të monitorimit. BE-ja dhe Shtetet Anëtare që janë pjesë e Procesit të Berlinit, duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje raporteve të zbatimit. Ecuria në iniciativa dhe agjenda të reja, do të varet nga përparimi i arritur në zbatimin e projekteve dhe iniciativave aktuale.

¹⁵⁸ OEFZ, "Bashkimi Evropian dhe Ballkani Perëndimor pas Procesit të Berlinit – Reflektimi për Agjendën e BE-së për Zgjerim në kohëra të pasigurta", korrik 2017, e qasshme në: <https://goo.gl/paCGbP>

Ky raport është mbështetur nga:

Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim (SDC) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e Grupit për Huluntim të Politikave në Ballkan dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SDC-së, DANIDA-së apo KCSF-së.”

dhe

Ambasada e Mbretërisë së Norvegjisë



Norwegian Embassy

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Grupit për Huluntim të Politikave në Ballkan (BPRG) dhe nuk i përfaqëson apo reflekton pikëpamjet ose opinionet e SDC-së, DANIDA-s dhe KCSF-së.

Grupi për Huluntim të Politikave në Ballkan (BPRG)

Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (BPRG) është organizatë (Think Tank institute) e pavarur rajonale, me seli në Prishtinë, Kosovë. Ne ofrojmë analiza të detajuara të politikave zhvillimore për një sërë çështjesh të ndërlydhura me shtet-ndërtimin, konsolidimin institucional e demokratik; integrimin e minoriteteve, dhe marrëdhëniet ndërshtetërore; si dhe integrimin evropian dhe reformat politike.

Ne kemi dekada përvojë në hartim, raportim dhe zhvillim të politikave, qasje strategjike dhe avokim tek qeveritë, institucionet ndërkombëtare, si dhe organizatat joqeveritare.

Në thelbin e punës sonë qëndrojnë raportimet tona të sakta, të detajuara dhe të paanshme, gjithmonë të bazuara në hulumtimet tona nga terreni. Ne shkojmë përtej qëndrimeve të etabluara dhe synojmë të bëjmë ndryshime përmes rekomandimeve për politika për të ardhmen e që janë kreative, të realizueshme dhe të matshme, duke kontribuar që vendet tona të zhvillojnë shoqëri dhe shtete të fuqishme demokratike, të qëndrueshme dhe të suksesshme bazuar në sundimin e ligjit.

Grupi për Ballkan ka dizajnuar edhe instrumente të reja për të arritur këtë ndryshim, siç janë: Dialogu Politik, Forumi Politik (Forum për Avokim i nivelit të lartë i organizatave Think Tank) dhe Forumi i Shoqërisë Civile për Bashkëpunim Ndërkufitar.

Për më shumë, vizitoni ueb-faqen tonë www.balkansgroup.org ose, na kontaktoni në office@balkansgroup.org



Norwegian Embassy



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Federal Department of Foreign Affairs FDFA



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION